



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

STANDARDE PËR TEKSTET SHKOLLORE

Tiranë, 2014

PËRGATITJA DHE REDAKTIMI SHKENCOR

Dr. Agim LEKA

Prof. Asc. Dr. Pëllumb KARAMETA

BASHKËPUNUAN

1. Prof. Asc. Dr. Sotir RRAPO
2. Yllka SPAHIU
3. Erida KOLECI
4. Mirela KAMSI
5. Evis MASTORI
6. Ines TODHE
7. Aurela ZISI
8. Albana MARKJA
9. Majlinda HALA

REDAKTOR LETRAR

Dr. Besnik RAMA

HYRJE

Qëllimi dhe funksionet e standardeve për tekstet shkollore	5
Konteksti i ri kurrikular i standardeve për tekstet shkollore	6
Llojet, treguesit, përshkruesit dhe vlerat e standardeve	8
Vlera e standardit. Llogaritja e saj	10
Renditja e tekstit shkollor	11
Konkurrimi, renditja, miratimi, pilotimi dhe certifikimi	11
Objektiviteti gjatë vlerësimit të tekstit shkollor	13

**PJESA I: STANDARDE TË PRANIMIT NË KONKURS
TË TEKSTIT SHKOLLOR**

Pranimi i tekstit shkollor në konkurs	15
Kritere teknike që duhen plotësuar nga tekstit shkollor	16

PJESA II: STANDARDE TË PËRGJITHSHME

Pajtimi me kurrikulën, formatimi, paraqitja (standardet 1-3)	
Pajtimi me parimet gjithëpërfshirëse kurrikulare dhe me tekstet e klasave pararendëse dhe pasuese (të së njëjtës lëndë)	19
Faqosja, planifikimi/kompozimi, qëndrueshmëria	20
Ilustrimet	21

Çështje shkencore dhe didaktike (standardet 4-8)

Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësia, aktualiteti	22
Përshtatja me moshën e nxënësve/eve	23
Konceptimi dhe shtjellimet didaktike	24
Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat	26
Aspektet gjuhësore	27

Çështje pedagogjike (standardet 9-12)

Lidhja me realitetet politike, historike dhe shoqërore	28
Çështjet edukative, pavarësia/pjekuria, edukimi për	

demokraci/paqe	29
Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor	30
Lidhja me çështje të tjera pedagogjike të rëndësishme	31
Çështje që lidhen me praktikën shkollore (standardet 13-15)	32
Teksti/udhëzuesi i mësuesit dhe përdorimi i tij	33
Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor	34
Pilotimi i tekstit shkollor	
PJESA III: STANDARDET PLOTËSUESE SIPAS LËNDËVE	
Standardi për tekstin shkollor “Abetare”	36
“Gjuhë shqipe për shkollën 9-vjeçare”; “Gjuhë shqipe dhe letërsi (bërthamë)”	38
Standardi për tekstet shkollore të gjuhëve të huaja	40
Gjuha shqipe për pakicat në Republikën e Shqipërisë	42
Matematika	44
Shkencat e natyrës	47
Shkencat shoqërore. Historia	50
Qytetaria	52
Shkencat e tjera shoqërore	54
Muzika	56
Arti pamor	58
Aftësim teknologjik (klasat 1 - 5)	60
Teknologjia/TIK-u	62
Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	64
SHTOJCA 1: Formulari përmbledhës	66
BIBLIOGRAFIA	67

HYRJE

QËLLIMI DHE FUNKSIONET E STANDARDEVE PËR TEKSTET SHKOLLORE

Teksti shkollor, si mjet i rëndësishëm arsimor dhe edukativ, plotëson disa **funksione**, të tilla si:

- Paraqitja e përmbajtjeve mësimore përmes të cilave u mundësohet nxënësve/eve të ndërtojnë/të demonstrojnë njohuritë e reja dhe kompetencat e tyre.
- Sigurimi i ndihmës për nxënësit/et që të punojnë me tekstin shkollor.
- Zhvillimi i qasjeve të ndryshme të nxënies.
- Mbështetja për vlerësimin dhe për vetëvlerësimin e rezultateve të nxënies.
- Sigurimi i udhëzimeve për mësuesin/en se si të përdorë tekstin shkollor.

Standardet për Tekstet Shkollore (STSh) i shërbejnë plotësimin të këtyre funksioneve. Ata paraqesin **kritere/aspekte** që duhen përmbushur nga tekstet shkollore, për të ndihmuar nxënësit/et të arrijnë **qëllimet arsimore të arsimit parauniversitar**: *zhvillimin e identitetit vetjak/kombëtar dhe të përkatësisë kulturore; përvojën e vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare; zhvillimin në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike; zhvillimin e përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit; aftësimin për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; aftësimin për të nxënë gjatë gjithë jetës; zhvillimin e shpirtit të sipërmarrjes dhe përdorimin e teknologjive të reja*^[1].

I vendosur në këtë kontekst, dokumenti i STSh-ve, vlen si **instrument normativ praktik** për specialistët/et e arsimit dhe mësuesit/et, për shtëpitë botuese të teksteve shkollore, për autorët/et, për recensuesit/et dhe për komisionet e certifikimit të teksteve shkollore. Ai ofron **kriteret thelbësore** për vlerësimin e teksteve shkollore dhe **një metodologji vlerësimi** praktike dhe të përdorshme.

Dokumenti u shërben përdoruesve të tij për të realizuar vlerësime të njësuara të teksteve shkollore, bazuar në kritere të përcaktuara dhe të pranuar. Më së pari:

- **për vlerësimin e teksteve shkollore ekzistuese**, pasi standardet veprojnë: a) si instrument për të përcaktuar nevojat dhe kërkesat e zhvillimit të mëtejshëm, p.sh., caktimi i pikave kryesore për përmirësimin e tekstit shkollor; b) si kuadër i përbashkët të cilit i referohen personat që vlerësojnë tekstet shkollore;

[1] Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë

- **për përpunimin e mëtejshëm të teksteve shkollore ekzistuese ose për krijimin e teksteve të reja shkollore**, pasi standardet u shërbejnë autorëve/eve dhe shtëpive botuese të teksteve shkollore si mjet që i orienton tek aspektet që duhen përmbushur dhe treguesit që duhen respektuar;
- **për vlerësimin/certifikimin e teksteve shkollore të përpunuara ose të reja**, sepse standardet shërbejnë si kuadër i përbashkët normativ të cilit u referohen institucionet ose personat që merren me klasifikimin/renditjen, me miratimin dhe me certifikimin e teksteve shkollore.

Për hartimin e STSh-ve, janë shfrytëzuar prurjet e dokumentit “Standarde për tekstet shkollore - 2011” të Republikës së Kosovës dhe përvojat e mira të vendeve të rajonit e më gjerë. Gjithashtu, janë konsideruar prurjet tona për përgatitjen e teksteve shkollore.


KONTEKSTI I RI KURRIKULAR I STSh-ve

STSh-të mbështeten në përcaktimet dhe në orientimet e **paketës së re kurrikulare** të arsimit parauniversitar, si: Korniza Kurrikulare, kurrikulat bërthamë, plane dhe programe mësimore etj. Paketa paraqet drejtimet arsimore kryesore të veprimtarisë së personelit të shkollës dhe njohuritë/kompetencat thelbësore që do t’u nevojitet nxënësve/eve tanë, sot e në të ardhmen. Paketa është konceptuar dhe zhvilluar që të sigurojë zhvendosjet:

- nga kurrikula që përqendrohet në lëndët, te kurrikula që bazohet në kompetencat;
- nga përqendrimi te mësuesi/ja, te përqendrimi mbi nxënësin/en;
- nga metodologjia ligjëruese, te metodologjitë ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Paketa e re përcakton themelet e kontratës morale të institucioneve arsimore me shoqërinë, veçanërisht, me prindërit dhe me nxënësit/et. Në dritën e misionit të ri të shkollave (arsimim, shoqërizim dhe kualifikim), kurrikula e reformuar jetëson **qasjen kurrikulare që bazohet në kompetenca**, e cila përfshin të gjitha përmasat e zhvillimit të nxënësve/eve dhe shërben për të materializuar vizionin e ri arsimor të shoqërisë shqiptare dhe pritshmëritë që duhet të plotësojnë nxënësit/et tanë. Qasja mundëson *ndërtimin/demonstrimin e kompetencave nga nxënësit/et; integron lëndët në një të tërë koherente të fokusuar në çështjet kryesore të jetës; synon qartësisht të nxënit ndërkurrikular që i kapërcen kufijtë mes lëndëve; kërkon ekspertizë profesionale nga mësuesit/et dhe u lejon atyre zgjedhje individuale dhe kolektive; krijon mundësi të barabarta për sukses për të gjithë nxënësit dhe ofron zgjidhje që respektojnë stilet vetjake të nxënies dhe përvojat nga nxëniet e mëparshme, si kushte për përmirësimin e niveleve të arritjeve.*

E kuptuar në tërësi, kurrikula e re integron një **grup lëndësh mësimore**^[2] (dhe **tekstet shkollore** përkatëse), si pjesë e *burimeve të jashtme* që përdoren gjatë nxënies. Lëndët organizohen në shtatë **fusha të nxëni** (gjuhët dhe komunikimi, matematika, shkencat e natyrës etj.) që grupojnë lëndë të lidhura ose me fokuse të përbashkëta. Fushat e të nxënit përfshijnë aspekte shoqërore dhe kulturore që u mundësojnë nxënësve/eve të zhvillojnë kombinime të **kompetencave** (kapacitete vetjake që integrojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime etj., përmes të cilave personi trajton në mënyrë efektive situatat), duke i aftësuar ata të marrin pjesë në evolucionin shoqëror dhe kulturor të botës së tyre. Burimet e jashtme dhe *burimet e brendshme* (gjithë sa personi aktivizon si njohuri, shkathtësi, qëndrime, motive, emocione etj.), janë mjete që përdor dhe/ose nxit mësuesi për të ndihmuar nxënësin/en të ndërtojë kompetencat (kyçe dhe lëndore). Kompetencat ndërtohen/përsosen gjatë ndërveprimeve të nxënësit/es në situata të ndryshme që ofrohen nga teksti shkollor, nga mjedisi i nxënies dhe nga kontekste më të gjera jetësore të cilat kurrikula e re i përcakton si **tema ndërlëndore**. Në këtë kontekst, realizohet veprimtaria e shkollës për t’u mundësuar nxënësve/eve të zhvillojnë njohuri të reja dhe kompetenca, në funksion të **qëllimeve arsimore të APU-së**.



[2] Në këtë dokument, *lënda mësimore* nënkupton dijet, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet të cilat janë objekt i të nxënit të një aspekti/fushe të caktuar.

Parimet, orientimet dhe kërkesat e paketës së re kurrikulare formojnë kornizën konceptuese të standardeve për tekstet shkollore.

LLOJET, TREGUESIT, PËRSHKRUESIT DHE VLERA E STANDARDEVE

Në këtë dokument, për vlerësimin e çdo teksti shkollor përdoren tre grupe standardesh:

- Standarde të pranimit në konkurs të tekstit shkollor.
- Standarde të përgjithshme.
- Standarde plotësuese sipas lëndëve.

STANDARDE TË PRANIMIT NË KONKURS

Standardet e pranimit në konkurs, që vlejnë për të gjitha tekstet shkollore, përmbajnë tregues, mospërmbushja qoftë dhe e njërit prej tyre, i heq të drejtën tekstit shkollor për të konkurruar. Të tillë janë:

- Standardi i pranimit të tekstit shkollor në konkurs.
- Standardi teknik.

STANDARDE TË PËRGJITHSHME

Standardet e përgjithshme vlejnë për të gjitha tekstet shkollore, edhe pse jo me të njëjtën peshë. Standardet e përgjithshme janë organizuar në katër fusha:

- A. Pajtimi me kurrikulën, formatimi, paraqitja (standardet 1-3).
- B. Çështje shkencore dhe didaktike (standardet 4-8).
- C. Çështje pedagogjike (standardet 9-12).
- D. Çështje që lidhen me praktikën pedagogjike (standardet 13-15).

STANDARDE PLOTËSUESE SIPAS LËNDËVE

Standardet paraqesin kërkesat e veçanta që duhen plotësuar nga teksti, varësisht lëndës.

TREGUESI I STANDARDIT

Çdo standard shtjellohet përmes *treguesve* të tij. Treguesit e standardit paraqesin *aspekte* të pjesshme, konkrete dhe të zbatueshme (me sa është e mundur), përmes të cilave mund të gjykohet se deri në ç'masë është përmbushur standardi. Masat e përmbushjes së aspekteve të treguesit shprehet nëpërmjet *përshkruesve të përmbushjes*.

PËRSHKRUESI I PËRMBUSHJES

Përshkruesi i përmbushjes tregon se në ç'masë/nivel aspektet e treguesit/standardit përmbushen nga teksti shkollor. Meqenëse kërkesat e treguesit mund të përmbushen në masa të ndryshme, përdoren këta përshkrues:

PËRSHKRUESI I PËRMBUSHJES	MASA E PËRMBUSHJES SË TREGUESVE
Nuk përmbushen	Aspektet e treguesit në fjalë nuk janë respektuar aspak nga teksti shkollor.
Përmbushen pjesërisht	Disa nga aspektet e treguesit mund të jenë mbajtur parasysht, por teksti shkollor nuk i përmbush ato sa e si duhet.
Përmbushen mjaftueshëm	Vetëm disa prej aspekteve të treguesit përkatës përmbushen nga teksti shkollor.
Përmbushen mirë	Aspektet e treguesit përkatës janë përmbushur mirë nga teksti shkollor, por disa përmirësime janë të mundshme.
Përmbushen shumë mirë	Aspektet e treguesit përkatës janë përmbushur plotësisht nga teksti shkollor.

Dallimet ndërmjet niveleve/përmasave të përmbushjes së aspekteve të treguesve nga teksti shkollor i shpreh *vlera e përshkruesit të përmbushjes*.

VLERA E PËRSHKRUESIT

Vlera e përshkruesit të përmbushjes së treguesit/standardit shpreh se deri në ç' masë përmbushen aspektet e treguesit/standardit nga teksti shkollor. Në dokumentin e STSh-ve, vlerat e përshkruesve shprehen me një nga numrat 0-4. Lidhja ndërmjet përshkruesve dhe vlerave përkatëse paraqitet në tabelë:

PËRSHKRUESI	VLERA
Nuk përmbushen	0
Përmbushen pjesërisht	1
Përmbushen mjaftueshëm	2
Përmbushen mirë	3
Përmbushen shumë mirë	4

Me ndihmën e përshkruesve dhe të vlerave të tyre llogaritet **vlera e standardit**.

VLERA E STANDARDIT. LLOGARITJA E SAJ

Lidhja e përshkruesve me vlerat përkatëse lejon që, me ndihmën e një formule të thjeshtë, të caktohet *vlera e standardit*, si në vijim:

- Për secilin tregues të standardit, sipas masës së përmbushjes së aspekteve nga teksti shkollor, identifikohet vlera e përshkruesit me simbolin **X**, në kutinë përkatëse.
- Vlerat e përshkruesve të treguesve mbliidhen. Shuma pjesëtohet me numrin e treguesve.
- Rezultati, me afërsi deri tek e dhjeta, përcaktohet si **vlera e standardit**.^[3]

ILUSTRIM

Standardi 1: Pajtueshmëria me parimet gjithëpërfshirëse kurrikulare dhe me tekstet shkollore të klasave paraardhëse dhe pasuese (të së njëjtës lëndë).

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1	Teksti shkollor përputhet me parimet e qasjes që zhvillon kompetencat dhe me kërkesat e kurrikulës bërthamë për secilën shkallë kurrikulare (kompetencat kyçe, kërkesat për përparimin e nxënësit/es, struktura e organizimit të përvojave të nxënies) dhe me programin mësimor të lëndës dhe të klasës përkatëse.				X	
1.2	Teksti shkollor përputhet me parimet dhe me kërkesat e programit mësimor të lëndës dhe të klasës për të cilën është përgatitur.			X		
1.3	Teksti shkollor përshtatet me konceptimin dhe me renditjen e teksteve shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese; ai përputhet (sa i përket terminologjisë) me konceptimin dhe me mënyrën e të nxënësit të teksteve shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese dhe ruan vazhdimësinë e programit mësimor të lëndës në fjalë (duke respektuar trajtimin dhe thellimin e disa aspekteve në nivele më komplekse).					X
Shuma e vlerave të tregueseve (1.1 + 1.2 + 1.3) = 3 + 2 + 4 = 9 Vlera e standardit $1 = 9 : 3 = 3$ (I përmbushur mjaftueshëm)						

[3] Për vlerat deri në 0.4 pas presjes, konsiderohet vlera numerike e plotë më e ulët. Mbi këtë shifër, konsiderohet vlera numerike e plotë më e lartë.

RENDITJA E TEKSTIT SHKOLLOR

Që teksti shkollor i pranuar në konkurs të përzgjidhet **për t'u renditur**, duhet të përmbushë standardet e përgjithshme dhe ato lëndore të paktën në **vlerën 3** (i plotësuar mjaftueshëm). Nëse vlera e standardit është **3** ose **4**, por ka tregues të tij që e kanë vlerën të barabartë ose më të vogël se **2**, Komisioni i Vlerësimit do të kërkojë me shkrim përmirësimin e aspekteve të këtyre treguesve.

Për renditjen e teksteve shkollore, Komisioni i Vlerësimit krahason vlerat e standardeve dhe të treguesve përkatës të këtyre teksteve.

KONKURRIMI, RENDITJA, MIRATIMI, PILOTIMI DHE CERTIFIKIMI

MAS-i, përmes Komisionit të Vlerësimit ^[4], shpall konkursin për tekste shkollore dhe listën e kriterëve që duhet të plotësojë çdo botues i licencuar për t'u pranuar në konkurs. **Rregullorja** e organizimit dhe e funksionimit të Komisionit, si dhe **Rregullorja** e konkursit, miratohen nga Ministri. MAS-i përcakton **dokumentacionin** e nevojshëm për konkurrim dhe **karakteristikat** e fazave të konkursit. Fazat (F) dhe objektivat kryesorë sipas fazave paraqiten në vijim.

F1. Shpallja e konkursit

Publikimi nga Komisionit i nevojës për tekste shkollore, nxitja e konkurrencës dhe pranimi i dokumentacionit ^[5] për konkurrim.

F2. Përgatitja e tekstit shkollor

Botuesit përgatitin fashikujt e tekstit shkollor ose dorëshkrimin e tij.

F3. Vlerësimi paraprak

Komisioni, duke respektuar anonimatën e botuesit, u dorëzon recensuesve **fashikujt** ose **dorëshkrimin** e tekstit shkollor që paraqitet në konkurs. Recensuesit:

- Studiojnë me hollësi fashikujt/dorëshkrimin e tekstit shkollor (përfshirë udhëzuesin për mësues dhe materialet shtesë).
- Vlerësojnë fashikujt, pavarësisht njëri tjetrit, duke caktuar vlerat e treguesve të çdo standardi (me simbolin **X** në kutinë përkatëse) dhe, për çdo standard, nëse duhet, plotësojnë një formular me rubrikat “Vërejtje” dhe “Sugjerime për përmirësim”,

[4] Komisioni i Vlerësimit ngrihet me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

[5] Botuesit, përveç dokumenteve që provojnë statusin e tyre juridik, mund të dorëzojnë, fillimisht, vetëm disa fashikuj të tekstit shkollor, numri dhe karakteristikat e të cilëve përcaktohen në “Rregulloren e konkursit”. Si alternativë e fashikujve, mund të përdoret dorëshkrimi i tekstit shkollor.

bazuar në vlerat e treguesve. Këto shënime, në fazën vijuese, shërbejnë si bazë për përmirësimin e dorëshkrimeve.

- Llogaritin për secilin standard vlerën e tij, sipas formulës përkatëse.
- Plotësojnë me fjalë formularin përmbledhës (shtojca 1, në fund të dokumentit të STSh-ve) dhe rubrikat e tjera. Formulari jep një profil të fashikujve/dorëshkrimit të tekstit shkollor të vlerësuar.
- Në varësi të vlerësimit përmbledhës, grupojnë fashikujt/dorëshkrimet e teksteve shkollore që vlerësuan në tri kategori të mundshme: a) fashikuj/dorëshkrime që përmbushin STSh-të; b) fashikuj/dorëshkrime që, mund të përmbushin STSh-të, pasi të përmirësohen aspektet e treguesve të caktuar; c) fashikuj/dorëshkrime që nuk i plotësojnë STSh-të.
- I paraqesin me shkrim Komisionit të Vlerësimit komentet dhe vlerësimet e tyre.
- Komisioni i Vlerësimit pranon të mirëqenë fashikujt/dorëshkrimet që plotësojnë STSh-të; rekomandon përmirësime për ata që mund të përmirësohen; refuzon, duke argumentuar, fashikujt/dorëshkrimet që nuk plotësojnë STSh-të.

F4. Vlerësimi

- Komisioni, duke respektuar anonimin e botuesit, u dorëzon recensuesve për vlerësim **dorëshkrimet** e teksteve shkollore që përmbushin standardet.
- Në rastet e vlerësimit vetëm të fashikujve, recensuesit, për të vlerësuar dorëshkrimet e tekstit shkollor, përsëritin procedurën me të cilën vlerësuan fashikujt. Rezultatet i paraqiten Komisionit të Vlerësimit.

F5. Renditja dhe miratimi

Komisioni i Vlerësimit, bazuar në vlerësimin e recensuesve, **rendit dorëshkrimet** e teksteve shkollore sipas vlerave përkatëse dhe **miraton** pilotimin e teksteve fituese. Botuesit përgatitin tekstet shkollore.

F6. Pilotimi ^[6]

Tekstet shkollore pilotohen në rrjetin e shkollave pilot.

F7. Certifikimi

Tekstet shkollore që, pas pilotimit, Komisioni i Vlerësimit i konfirmon të arrira, certifikohen nga MAS-i për t'u përdorur në sistemin e APU-së.

[6] Pilotimi në grupin e 26 shkollave pilot (30 klasa me mbi 900 nxënës) konfirmon vlerat e tekstit shkollor dhe aspektet që mund të përmirësohen; kështu, verifikohen edhe vendimet e marra më herët nga recensuesit dhe nga Komisioni i Vlerësimit.

OBJEKTIVITETI GJATË VLERËSIMIT TË TEKSTIT SHKOLLOR

Përfundime dhe rezultate objektive të paraqitura me numra mund të arrihen vetëm për një numër të kufizuar treguesish (të tillë, p.sh., janë standardet 11.1 dhe 11.2 që lidhen me përdorimin e termave sa u përket gjinive, prania e barabartë e vajzave dhe e djemve në ilustrimet etj.). Në shumë raste, nuk mund mënjanohet tërësisht aspekti subjektiv sepse, karakteristika si “përshtatshmëria (me moshën e nxënësve/eve)” ose “cilësia e ilustrimeve” etj., për të cilat nuk ka përcaktime të standardizuara, interpretohen nga secili recensues në mënyrë vetjake.

Përmirësimin të objektivitetit i ndihmojnë:

- Vlerësimi i tekstit shkollor, në kushtet e anonimatit të botuesit, nga të paktën tre recensues të certifikuar, të pavarur dhe të kualifikuar (eksperti në disiplinën përkatëse, eksperti në njohjen e standardit të gjuhës shqipe, eksperti në didaktikën lëndore). Nëse recensuesit e ndajnë punën sipas specializimeve të tyre, atëherë, për secilin standard bëhen vlerësime dhe sugjerime nga të paktën dy recensues.
- Spektri i gjerë me rreth 100 tregues (numri varet nga përmasat e standardit 16) të përdorur për vlerësim, ofron një pamje të diferencuar dhe të hollësishme të tekstit shkollor; njëkohësisht, shmang rrezikun e vlerësimeve tepër të përgjithshme dhe sipërfaqësore.
- Krahasimi i vlerave për disa tregues të njëjtë të çdo standardi.

PJESA I

STANDARDE TË PRANIMIT NË KONKURS TË TEKSTIT SHKOLLOR

Standardi: Pranimi i tekstit shkollor në konkurs

Qëllimi: Që të pranohet në konkurs, teksti shkollor nuk duhet të përmbajë asnjë aspekt/karakteristikë që bie ndesh me dispozitat e kuadrit ligjor, me përcaktimet e paketës kurrikulare dhe me kriteret teknike të përcaktuara.

Shënim: Teksti shkollor nuk kualifikohet për konkurrim, nëse konstatohet që në përmbajtjen dhe në përgatitjen e tij reflektohet qoftë dhe një nga treguesit e mëposhtëm.

Nr.	Treguesi	PO	JO
1	Elemente të tekstit shkollor bien ndesh me kuadrin ligjor ekzistues.		
2	Teksti shkollor nuk respekton përcaktime të paketës kurrikulare.		
3	Në tekstin shkollor konstatohen pohime që bien në kundërshtim me kodin e etikës së shoqërisë.		
4	Në tekstin shkollor konstatohet paragjykitje sociale, etnike, racore, fetare, moshore, gjinore, gjeografike, si dhe elemente të frymës së urrejtjes dhe të nxitjes së armiqësisë për popujt e tjerë.		
5	Në tekstin shkollor konstatohen gabime shkencore.		
6	Në tekstin shkollor konstatohen gabime gjuhësore.		
7	Në tekstin shkollor konstatohen mospërputhje ndërmjet ngarkesës së tekstit dhe moshës së nxënësve.		
8	Në tekstin shkollor konstatohen ilustrime të pasakta që nuk kanë lidhje me temën që trajtohet.		
9	Në tekstin e gjuhës shqipe përfshihen tekste ose fragmente të autorëve që nuk janë përfaqësues të denjë të letërsisë shqipe / botërore dhe që nuk kanë vlera estetike dhe gjuhësore.		
10	Në tekstin shkollor të historisë/të gjeografisë konstatohen harta të gabuara.		
11	Në tekstin shkollor konstatohen situata (problema, ushtrime etj.) që nuk janë formuluar qartë dhe saktë.		
12	Në tekstin shkollor konstatohen të dhëna të vjetruara, që sot nuk kanë vlerë.		
13	Teksti shkollor përmban reklama / promocione.		

Standardi: Kritere teknike minimale të tekstit shkollor

Qëllimi: Teksti shkollor duhet të plotësojë kritere teknike minimale të përcaktuara.

Shënim: Teksti shkollor nuk kualifikohet, kur nuk plotësohet qoftë dhe një nga treguesit e mëposhtëm.

Nr.	Elementet e tekstit	Kriteret	Po	Jo
1	Organizimi i përmbajtjes së tekstit shkollor	Përmbajtja e tekstit shkollor paraqitet në një vëllim		
2	Formati i prerë i tekstit shkollor	Kl. I - V 20 x 28 cm		
		Kl. VI -XII 18 x 25 cm		
3	Madhësia e germave	Kl. I-II Shkronja me font mbi 14		
		Kl. III - IX Shkronja me font mbi 12		
		Kl. X-XII Shkronja me font mbi 11		
4	Hapësira mes rreshtave	Hapësira mes rreshtave: 120% e shkronjave		
5	Lloji i letrës për librin	Asnjë lloj letre me lustër		
		Opaciteti 80 %		
		Shkëlqimi 83 %		
		Pesha e letrës së librit 70 gsm		
		Pesha e letrës së fletores së punës 70 gsm		
6	Lloji i letrës për kopertinë	Për libra deri 96 faqe 200 gsm		
		Për libra mbi 96 faqe 280 gsm		
7	Ngjyrat për bllokun e librit	Libri i nxënësit 4 ngjyra		
		Fletore pune e detyrueshme 2 ngjyra		
	Ngjyra për kopertinat	Kopertinat 4 ngjyra		
8	Lloji i lidhjes	Deri 96 faqe Me tel kaluar; 2 kapje		
		Mbi 96 faqe Ngjitje me hotmelt		
9	Elemente të detyrueshme të kopertinave	ISBN-ja		
		Barkod-i		
		Çmimi		
		Logo-ja e botuesit		

Sa i përket kompozimit të përmbajtjeve të tekstit shkollor, rekomandohet:	
•	Teksti shkollor të organizohet sipas kapitujve që fillojnë me faqen hyrëse ku gjenden përmbajtja e shkurtër, fjalët kyçe dhe përmbledhja e kapitullit.
•	Të gjitha temat e kapitujve të fillojnë në faqe të re.

- | |
|---|
| <ul style="list-style-type: none">• Në faqet e tekstit shkollor, përveç shkrimeve themelore, mund të vendosen tabela, ilustrime, fragmente etj. Pozicionin i tyre, në aspektin pamor, të mos dëmtojë tërësinë e tekstit; sipas mundësisë, të pozicionohen në skajet e jashtëm të faqes. |
| <ul style="list-style-type: none">• Për të gjithë titujt, të përdoret font i njëjtë si (nga madhësia dhe nga lloji). |
| <ul style="list-style-type: none">• Ilustrimet të paraqiten me tekst me font me madhësi më të vogël se teksti kryesor. |
| <ul style="list-style-type: none">• Numrat të jenë të nënvizuara dhe të veçuara nga teksti kryesor i faqes. |
| <ul style="list-style-type: none">• Fragmentet ku nxënësi duhet të ketë kujdes të posaçëm të veçohen nga teksti kryesor. |
| <ul style="list-style-type: none">• Ana e përparme, e ana e prapme dhe pjesa e shpinës së kopertinës të përbëjnë një tërësi pamore. |

PJESA II

STANDARDE TË PËRGJITHSHME

A. PAJTIMI ME KURRIKULËN, FORMATIMI, PARAQITJA (Standardet 1-3)

Standardi 1: Pajtimi me parimet gjithëpërfshirëse kurrikulare dhe me tekstet shkollore të klasave pararendëse dhe pasuese (të së njëjtës lëndë)

Qëllimet: *Teksti shkollor të materializojë parimet gjithëpërfshirëse të kurrikulës së re [7] dhe kërkesat specifike të programit të lëndës përkatëse. Teksti shkollor të ndihmojë nxënësit të ndërtojnë dhe të demonstrojnë njohuri të reja dhe kompetenca, që të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja. Teksti shkollor, sa u përket filozofisë së nxënies dhe mënyrës së të nxënit, të përputhet me tekstet shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese, duke garantuar vazhdimësinë dhe koherencën e kërkesave të programit mësimor.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
1.1	Teksti shkollor përputhet me parimet e qasjes që zhvillon kompetencat dhe me kërkesat e kurrikulës bërthamë për secilën shkallë kurrikulare (kompetencat kyçe, kërkesat për përparimin e nxënësit/es, struktura e organizimit të përvojave të nxënies).					
1.2	Teksti shkollor përputhet me parimet dhe me kërkesat e veçanta të programit mësimor të lëndës dhe të klasës për të cilën është përgatitur.					
1.3	Teksti shkollor përshtatet me konceptimin dhe me renditjen e teksteve shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese; ai përputhet (sa i përket terminologjisë) me konceptimin dhe me mënyrën e të nxënit të teksteve shkollore të së njëjtës lëndë të klasave pararendëse dhe pasuese dhe ruan vazhdimësinë e programit mësimor të lëndës në fjalë (duke respektuar trajtimin dhe thellimin e disa aspekteve në nivele më komplekse).					

Vlera e standardit 1 = {[1.1 + - + 1.3] : 3} = ____

[7] Tekstet e reja shkollore të krijojnë mundësi që organizimi i procesit të nxënies të zhvendoset nga objektivat e planifikuar për mësuesin, drejt arritjes së rezultateve të nxënies dhe të kompetencave që duhet të ndërtojë dhe demonstrojë nxënësi/ja.

Standardi 2: Faqosja, kompozimi/projektimi, qëndrueshmëria

Qëllimet: Teksti shkollor të ketë pamje aktuale tërheqëse, të jetë i strukturuar mirë, të ndihmojë orientimin e shpejtë në të dhe t'i rezistojë përdorimit të përditshëm ^[8].

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
2.1	Teksti shkollor ka paraqitje të jashtme dhe të brendshme aktuale dhe tërheqëse (sa u takon kopertinës, kompozimit të faqes, koherencës së konceptimit grafik me faqosjen, madhësisë së germave dhe largësisë mes rreshtave)					
2.2	Teksti shkollor, në tërësi, ka strukturë të qartë e të kapshme që lejon orientim të shpejtë dhe të lehtë (p.sh., përmes pasqyrës së lëndës, përmes simboleve orientuese etj., referuar moshës së nxënësve/eve).					
2.3	Teksti shkollor mundëson orientimin në secilën faqe në mënyrë të përshtatshme për moshën e nxënësve/eve; faqet nuk janë të mbingarkuara; përdoren si duhet elementet/ mjetet grafike (simbole dhe piktograme ^[9] që ndihmojnë orientimin) dhe ilustrimet.					
2.4	Burimet e teksteve të marra nga veprat e tjera janë dhënë me korrektësi.					
2.5	Fortësia e lidhjes, cilësia e letrës së përdorur për tekstin shkollor dhe për kapakun (e plastifikuar), si dhe cilësia e shtypit janë të tilla që teksti të mund të përdoret pa u dëmtuar gjatë vitit shkollor.					

Vlera e standardit 2 = $\{[2.1 + - + 2.5] : 5\} = \underline{\hspace{2cm}}$

[8] Për përcaktime më të hollësishme, shihni standardin teknik.

[9] Piktogrami: Simbol apo shenjë që shpalos kuptimin që mbart, përmes ngjashmërisë që ka me objektin që përfaqëson.

Standardi 3: Ilustrimet

Qëllimet: *Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktura, diagrame, tabela, grafikë, kutitë me komente të shkurtra shpjeguese) të jenë të kuptueshme dhe të nxitin vetëveprimin e nxënësit/es kur punon me tekstin shkollor [10].*

Cilësia e ilustrimeve të jetë e lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare dhe shpjeguese; ilustrimet të kenë përmbajtje që përputhet me vlerat morale [11].

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
3.1	Ilustrimet (fotografi, vizatime, piktograme, diagrame, tabela, grafikë etj.) plotësojnë shkrimet e tekstit mësimor (shihni shënimin 10)					
3.2	Ilustrimet kanë cilësi të lartë nga pikëpamja estetike, dokumentare apo shpjeguese (shihni shënimin 11).					
3.3	Ilustrimet janë të kuptueshme, të larmishme dhe përputhen me përmbajtjen e situatave të nxënies.					
3.4	Ilustrimet janë të mjaftueshme për njësitë mësimore.					

Vlera e standardit 3 = $\{[3.1 + - + 3.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

[10] Ilustrimet nuk duhet të paraqesin ose të riprodhojnë, thjesht, çka gjendet në tekst, por të përmbajnë informacion që plotëson tekstin, duke nxitur nxënësit/et të merren në mënyrë të thelluar me tekstin. Në tekstet shkollore të matematikës, të shkencave të natyrës dhe të gjeografisë, p.sh., diagramet, tabelat dhe grafikët të plotësojnë, të paraqesin apo të përmbledhin në mënyrë të kapshme atë që gjendet në tekst. Në tekstet shkollore të historisë dhe të shkencave të natyrës, fotografitë dokumentuese etj., të plotësojnë tekstin e shkruar, duke shtuar dokumente pamore autentike, të cilat nxitin procesin e të kuptuarit.

[11] Cilësia e lartë këtu nënkupton faktin që në librat e leximit, në tekste shkollore të historisë dhe të shkencave të natyrës, ilustrime me nivel të lartë estetik; në tekstet shkollore të matematikës dhe të shkencave të natyrës, fotografi të kapshme, me vlerë dokumentare ose shpjeguese; diagrame të qarta që nxitin procesin e të kuptuarit.

B. ÇËSHTJE SHKENCORE DHE DIDAKTIKE (Standardet 4-8)

Standardi 4: Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësinë dhe aktualitetin

Qëllimi: *Përmbajtja shkencore, shtjellimi didaktik i përmbajtjeve mësimore (përkatësisht, kombinimet shkrime – ilustrime) dhe situatat/përoojat e paraqitura në tekstin shkollor të tregojnë nivel të lartë, bashkëkohor dhe të përshtaten me synimet e temave të trajtuara. Duke plotësuar këtë standard, teksti shkollor t'i shërbejë ndërtimit dhe zhvillimit sistematik nga nxënësit/et të njohurive të reja, të kompetencave kyçe dhe atyre lëndore.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
4.1	Shkrimet e tekstit shkollor kanë përmbajtje cilësore; ato kanë vlera të larta formuese dhe edukative dhe përputhen me nevojat e sotme dhe me kërkesat e ardhme të shoqërisë.					
4.2	Nga pikëpamja shkencore, situatat, informacioni dhe aspektet e zgjedhura në tekstin shkollor janë korrekte në aspektin e lëndës, thelbësore dhe karakteristike për temën ose për nëntemat që shtjellohen.					
4.3	Shkrimet e zgjedhura, aspektet, sugjerimet metodike të përfshirjes së nxënësve dhe ushtrimet janë të përditësuara, sa u takon niveleve aktuale të shkencës përkatëse dhe të didaktikës së lëndës në fjalë.					
4.4	Duke qenë i mbështetur shkencërisht dhe bashkëkohor nga pikëpamja didaktike, teksti shërben për ndërtimin sistematik të njohurive të reja dhe të kompetencave të nxënësve/eve në lëndën përkatëse.					

Vlera e standardit 4 = $\{[4.1 + - + 4.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 5: Përshtatja me moshën e nxënësve/eve

Qëllimet: Përmbajtjet e tekstit shkollor, pamja, niveli i vështirësisë, faqosja dhe elemente të tjera të ngjashme me këto, të përshtaten me moshën e nxënësve/eve, për të cilët ai është konceptuar. Teksti shkollor të jetë i kuptueshëm, i vlefshëm nga ana mësimore - edukative dhe tërheqës për grup-moshën në fjalë (për aspektet gjuhësore, shihni standardin përkatës).

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
5.1	Përmbajtja e situatave të nxënies në tekstin shkollor përputhet mirë me mundësitë njohëse dhe përvetësuese të grup-moshës në fjalë.					
5.2	Përmbajtjet në tekstin shkollor (kombinimet informacion-ilustrim) janë në përputhje me përvojat, kërkesat, rrethanat e jetës së grup-moshës përkatëse. Për këtë, merren parasysh gjerësia dhe larmia e këtyre përvojave, rrethanave etj. Teksti shkollor u referohet në tërësi niveleve të ndryshme, duke u bërë i kapshëm dhe tërheqës për nxënësit/et.					
5.3	Elementet grafike të tekstit shkollor (fotografitë, grafikët etj.) përputhen me karakteristika e grup moshës në fjalë dhe janë të kapshme dhe tërheqëse për nxënësit/et.					
5.4	Paraqitja e jashtme dhe e brendshme (formati, faqosja, madhësia e shkronjave, largësia midis rreshtave etj.) i përshtaten grup-moshës në fjalë.					

Vlera e standardit 5 = $\{[5.1 + - + 5.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 6: Konceptimi dhe shtjellimet didaktike

Qëllimet: Teksti shkollor të ketë konceptim didaktik bashkëkohor që konkretizon kërkesat e qasjes që bazohet në kompetenca. Përgatitja, hartimi dhe shtjellimi i njësive/temave mësimore, i situatave të nxënies (ushtrime, detyra etj.) dhe i udhëzimeve, të mbështeten në parimet didaktike aktuale, si: të nxënit në mënyrë të pavarur, bashkëpunimi në grup, të nxënit ndërveprues, gjithëpërfshirës dhe reflektues etj. Teksti shkollor të ofrojë situata, materiale dhe sugjerime të përshtatshme për nivele intelektuale të ndryshme dhe stile të ndryshme të nxënies (kognitive/vizuale/vepruese etj.) që i shërbejnë arritjes së rezultateve përkatëse të nxënies dhe të kompetencave.

Shënim. Struktura e kuptueshme e tekstit shkollor dhe orientimet e qarta për qëllimet dhe për rezultatet e të nxënit ndihmojnë dhe prindërit të kuptojnë më mirë çka ndodh dhe çka kërkohet në procesin e të nxënit, që dhe ata të jenë në gjendje t'i ndihmojnë më lehtë fëmijët e tyre.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
6.1	Teksti shkollor është ndërtuar sipas një konceptimi didaktik të qartë dhe koherent të cilin e respekton me vendosmëri.					
6.2	Në tekstin shkollor, temat dhe situatat e të nxënit (shkrimet, detyrat, ushtrimet etj.) janë renditur nga e thjeshta te më e ndërlikuara.					
6.3	Përmbajtja e tekstit është ndarë në njësi dhe në hapa pune të përshtatshëm, të qartë e të kuptueshëm për nxënësit/et.					
6.4	Teksti shkollor, atje ku është e mundur, shpalos synimet e të nxënit, ofron situata të nxëni (detyra, ushtrime dhe sugjerime) të qarta që ndihmojnë nxënësit/et të orientohen me lehtësi, të vendosin synime dhe të vlerësojnë suksesin e arritjeve.					
6.5	Teksti shkollor, përmes ilustrimeve, grafikëve, shpjegimeve të fjalëve të pazakonshme dhe formulimeve, konkretizon të nxënit e qartë dhe të kuptueshëm.					
6.6	Për secilën (nën-) temë apo aspekt, teksti shkollor përmban situata (shkrime, materiale, ushtrime dhe detyra) në nivele të ndryshme, sa u përket kërkesave dhe vështirësisë. Teksti shkollor është i përshtatshëm edhe për punë të diferencuar në klasë.					
6.7	Përmes materialeve dhe udhëzimeve të përshtatshme, teksti shkollor nxit, ku është e mundur, të nxënit në mënyrë të pavarur.					
	Teksti shkollor u tregon nxënësve/eve mënyra, strategji dhe					

6.8	teknika për zhvillimin e aftësive metakognitive që lidhen me procesin e të nxënit.					
6.9	Situatat e përmbledhura në tekstin shkollor (tema, shkrime, ushtrime etj.) janë të përshtatshme për të punuar në forma të ndryshme bashkëpunuese, komunikuese dhe ndërvepruese (p.sh.: mësim me të gjithë klasën, punë në çifte, punë në grupe).					
6.10	Teksti shkollor përmban situata (materiale, sugjerime, detyra etj.) të cilat lejojnë shtjellime hyrëse të ndryshme në temë, sipas tipave dhe niveleve të ndryshme të nxënësve/eve.					
6.11	Teksti shkollor u shpjegon dhe u qartëson nxënësve/eve qëllimet, kërkesat, rrugët/mënyrat dhe rezultatet e të nxënit, çka ndihmon të orientohen vetë, të kenë parasysh qëllimet dhe të aftësohen të vetëvlerësojnë rezultatet e nxënies.					
6.12	Konceptimi dhe sugjerimet didaktike të tekstit shkollor janë të realizueshme, duke marrë parasysh kushtet materiale dhe infrastrukturore të shkollave shqiptare.					

Vlera e standardit 6 = $\{[6.1 + - + 6.12] : 12\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 7: Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat

Qëllimet: *Pyetjet dhe detyrat e paraqitura në tekstet shkollore, përveç njohurive, të nxitin edhe të nxënit e shkathtësive, të qëndrimeve dhe të vlerave. Pyetjet të jenë të formuluar thjesht, qartë, shkurt dhe saktë; të jenë të hapura, të nxitin krijimtarinë, që nxënësit/et të jenë aktivë në procesin e të nxënit dhe të mund të arrijnë në përfundime të pavarura.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
7.1	Pyetjet janë hartuar për nivele të ndryshme njohëse dhe bazohen në situatat që paraqiten në tekstin shkollor.					
7.2	Pyetjet, në aspektin metodologjik, janë të hartuara që t'i ndihmojnë nxënësit/et të zhvillojnë krijimtarinë e tyre.					
7.3	Formulimi i pyetjeve dhe i detyrave ndihmon nxënësit/et të zhvillojnë të menduarit kritik dhe të pavarur.					
7.4	Paraqitja e detyrave në tekstet shkollore nxit nxënësit/et të hulumtojnë vetë dhe të gjejnë burime të ndryshme të informacionit.					
7.5	Detyrat e përzgjedhura në tekstin shkollor i japin përparësi punës në grup të nxënësve/eve dhe zhvillojnë kompetencat kyçe dhe ato lëndore.					
7.6	Pyetjet dhe detyra në tekstin shkollor janë në përputhje me përmbajtjen e tekstit, të kuptueshme nga nxënësit/et dhe të përshtatshme për moshën e tyre.					

Vlera e standardit 7 = $\{[7.1 + \dots + 7.6]: 6\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 8: Aspektet gjuhësore

Qëllimet: *Gjuha e tekstit shkollor të jetë në përputhje me normat e gjuhës standarde dhe t'u shërbejë nxënësve/eve si model në jetë. Gjuha e tekstit t'u shërbejë nxënësve/eve për formimin/zbatimin e kompetencave kyçe, në veçanti të kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit. Nëpërmjet gjuhës së tekstit shkollor, nxënësi/ja të përkushtohet dhe të kontribuojë për bashkëbisedim konstruktiv, të respektojë rregullat e komunikimit, të shprehë tolerancë dhe empati (ndjeshmëri) në komunikim. Nga ana leksikore dhe sintaksore, gjatësia e shkrimeve mësimore (për njësi mësimore), duhet t'u përshtatet moshës dhe aftësive gjuhësore të moshës për të cilën teksti shkollor është përgatitur. Formulimet, sidomos të udhëzimeve, të pyetjeve dhe të detyrave, të jenë të kuptueshme dhe të thjeshta, që të nxitet të nxënit e pavarur të nxënësve/eve. Për të njëjtën temë, teksti shkollor të ofrojë shkrime dhe materiale me nivele gjuhësore të ndryshme, duke ndihmuar dhe duke nxitur me këtë të gjithë nxënësit/et.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
8.1	Leksiku i përdorur përputhet me moshën e nxënësve/eve, çka e bën gjuhën e tekstit shkollor të kuptueshme për ta.					
8.2	Ndërtimi sintaksor dhe gjuha e shkrimeve të tekstit shkollor përputhen me mundësitë gjuhësore të nxënësve/eve për të cilët është përgatitur teksti.					
8.3	Gjatësia e shkrimeve u përshtatet moshës dhe aftësive të leximit të nxënësve/eve.					
8.4	Formulimet, sidomos të detyrave dhe të udhëzimeve për punë të pavarur, janë të kuptueshme dhe të thjeshta, që nxënësit/et të punojnë në mënyrë të pavarur.					
8.5	Teksti shkollor përmban shkrime me nivele gjuhësore të ndryshme dhe me gjatësi të ndryshme, që nxënësit/et, me nivele kompetencash gjuhësore të ndryshme, të gjejnë materiale të përshtatshme për nivelin e tyre.					
8.6	Gjuha e tekstit shkollor, në aspektet morfologjike, sintaksore dhe drejtshkrimore, përputhet plotësisht me normat e standardit të gjuhës.					

Vlera e standardit 8 = {[8.1 + - + 8.6] : 6} = ____

C. ÇËSHITJE PEDAGOGJIKE (Standardet 9-12)

Standardi 9: Lidhja me realitetet politike, historike dhe shoqërore

Synimi: *Teksti shkollor të përputhet me parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Teksti shkollor të lidhet me realitetet shoqërore, historike dhe politike shqiptare, t'i shmanget çdo njëanshmërie dhe, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të ndihmojë dhe të nxitë pajtimin, tolerancën, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe komunikimin ndërmjet kulturave.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
9.1	Teksti shkollor, në aspektet politike, etnike dhe fetare, nxit tolerancën dhe pluralizmin, duke qenë vetë i hapur, tolerant dhe pluralist.					
9.2	Lidhjet e teksti shkollor me Shqipërinë dhe jetën në Shqipëri (sipas rastit), zhvillohen në kontekstin e shtetit demokratik dhe paqësor dhe të shoqërisë që synon bashkëjetesën paqësore të individëve dhe të grupeve të ndryshme etnike, fetare, shoqërore e kulturore.					
9.3	Teksti shkollor nuk i referohet në mënyrë të njëanshme një grupi ose një individ të veçantë dhe përvojave të tij. Me sugjerimet dhe detyrat e përmbledhura në të, teksti pasqyron realitetin pluralist, duke i shërbyer mirëkuptimit të njëri tjetrit dhe bashkëjetesës së qëndrueshme.					
9.4	Në tekstin shkollor, aspektet historike trajtohen në mënyrë të peshuar, objektive dhe pa emocione.					

Vlera e standardit 9 = $\{[9.1 + - + 9.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 10: Çështjet edukative, pavarësia dhe pjekuria, edukimi për demokraci dhe paqe

Qëllimet: *Teksti shkollor të nxitë zhvillimin e nxënësve/eve si qytetarë/e të pjekur, të pavarur të cilët i marrin vetë vendimet. Teksti shkollor të ndihmojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, edukimin për demokraci dhe për paqe, duke u orientuar drejt vlerave si toleranca, gatishmëria për bashkëpunim dhe marrja e përgjegjësi, kuraja qytetare, integrimi, heqja dorë nga dhuna, mbrojtja e pakicave etj. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo mund të ndodhë, p.sh., përmes zgjedhjes së shkrimeve në libra leximi ose në tekste shkollore të lëndëve, “Edukatë qytetare” apo “Histori”. Veç kësaj, aftësia për dialog, toleranca dhe arritja e barabartë e marrëveshjeve midis interesave dhe opinioneve të ndryshme, të ushtrohet në mënyrë të tërthortë dhe efikase në tekstet shkollore të lëndëve të ndryshme, përmes pyetjeve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, që nxitin dialogun dhe ndërveprimin midis nxënësve/eve, si dhe përmes sugjerimit të skenarëve didaktikë përkatës.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
10.1	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e pjekurisë dhe të pavarësisë së nxënësve/eve, nëpërmjet zgjedhjes dhe paraqitjes së situatave (shkrimeve, materialeve, pyetjeve, detyrave etj.) që nxitin dhe ndihmojnë nxënësit/et të mendojnë në mënyrë të pavarur dhe kritike. Për aspektin e fundit, kontribuojnë dhe udhëzimet për strategjitë e të nxënësve, për vetëkorrigjim etj.					
10.2	Në zgjedhjen e shkrimeve, të materialeve dhe të detyrave, teksti shkollor fokusohet (aq sa është e mundur në lëndën përkatëse) rreth qëllimeve dhe vlerave të edukimit për demokraci dhe për paqe.					
10.3	Teksti shkollor, nëpërmjet pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, ndihmon (sipas rastit) në edukimin për demokraci dhe për paqe (aftësi për dialog, gatishmëri për kooperim, shkathtësi komunikimi në situata konflikti, tolerancë etj.).					
10.4	Teksti shkollor ndihmon në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave lëndore, personale dhe sociale.					

Vlera e standardit 10 = $\{[10.1 + - + 10.4] : 4\} =$ _____

Standardi 11: Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor

Qëllimet: Teksti shkollor të edukojë barazinë gjinore, të shmangë dallimet lidhur me gjininë dhe stereotipat gjinorë në lidhje me ndarjen e roleve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndihmesa të jepet nga tekstet shkollore të disa lëndëve (libra leximi, tekste shkollore të shkencave shoqërore), nëpërmjet zgjedhjes së përshtatshme të situatave (shkrime, pyetje dhe detyra). Në mënyrë të tërthortë, të gjitha tekstet shkollore duhet të plotësojnë këtë standard, duke u kujdesur që: a) nga ana gjuhësore, të respektohen të dyja gjinitë (përdorimi i trajtave femërore dhe mashkullore, p.sh., nxënës/e); b) në shkrime, në ilustrime, në detyra etj., femrat dhe meshkujt të jenë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe jo sipas stereotipave tradicionalë.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
11.1	Gjuha e tekstit shkollor u përshtatet të dy gjinive (përdorim i trajtave mashkullore dhe femërore, p.sh., në problema, në udhëzime, detyra etj.).					
11.2	Në shkrimet, ilustrimet, detyrat, pyetjet etj., meshkujt dhe femrat janë përfaqësuar në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh, kur e lejon natyra e temës.					
11.3	Në shkrimet e situatave (ilustrime, detyra, pyetje etj.), teksti shkollor u referohet në mënyrë të barabartë dhe po aq shpesh përvojave dhe interesave të femrave dhe të meshkujve.					
11.4	Teksti shkollor u shmanget stereotipave gjinorë, në lidhje me ndarjen e roleve dhe të pamjeve të njëanshme, duke treguar dhe paraqitur femra dhe meshkuj në veprimtari dhe kontekste të ndryshme.					
11.5	Të dyja gjinitë portretizohen, pasqyrohen dhe kanë role në mënyrë të barabartë si në jetën private (në familje), ashtu dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore (në sferën publike, në kontekst historik etj.).					
11.6	Përdorimi i gjuhës është i drejtë dhe i barabartë për të dyja gjinitë, sidomos kur përdoren format femërore dhe mashkullore në emërtimin e personave.					
11.7	Teksti shkollor ka shtrirje sasiore dhe kombinim cilësor të fotografive dhe të veprave të artit, në lidhje me barazinë gjinore dhe në përputhje të plotë me temat dhe kapitujt që trajton.					

Vlera e standardit 11 = $\{[11.1 + \dots + 11.7] : 7\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 12: Lidhja me çështje të tjera pedagogjike të rëndësishme

Qëllimet: Teksti shkollor, me sa mundet, të plotësojë kërkesat e fushave që janë me rëndësi të madhe edukative: edukimi për ruajtjen e mjedisit, edukimi shëndetësor, edukimi mediatik (d.m.th. përdorimi i përshtatshëm i mediave dhe qëndrimi i pavarur ndaj tyre), edukimi kundër përdorimit të drogave etj. Në disa tekste shkollore (libra leximi, tekstet e lëndëve “Edukatë”, “Gjeografi”, “Biologji”, “Sociologji” etj.), kjo ndihmesë të jepet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por, dhe tekstet shkollore të lëndëve të tjera, të kontribuojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për këto qëllime, qoftë nëpërmjet zgjedhjes së shkrimeve dhe të shembujve të përshtatshëm, qoftë nëpërmjet situatave të përshtatshme (pyetjeve, detyrave apo sugjerimeve për diskutime).

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
12.1	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kultivon ndjenjën e dashurisë ndaj mjedisit dhe formon ndërgjegjen për ruajtjen e tij.					
12.2	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon në edukimin shëndetësor (duke bërë objekt aspekte, si ushqimi, sporti/lëvizja, higjiena).					
12.3	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon për përdorimin e përshtatshëm të mediave dhe për edukimin e qëndrimit të pavarur ndaj tyre (p.sh., duke nxitur nxënësit/et të bëjnë hulumtime në internet, të krahasojnë gazeta/burime të ndryshme etj.).					
12.4	Teksti shkollor, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, ndihmon edukimin për parandalimin e përdorimit të duhanit, të alkoolit dhe të drogës.					

Vlera e standardit 12 = $\{[12.1 + - + 12.4] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

D. ÇËSHTJE QË LIDHEN ME PRAKTIKËN SHKOLLORE (Standardet 13-15)

Standardi 13: Teksti/udhëzuesi i mësuesit/es dhe përdorimi i tij

Qëllimet: Në tekstin për mësuesin: 1) të shtjellohen në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë qëllimet, konceptimi didaktik, struktura/ndërtimi, pikat kyçe të tekstit shkollor dhe mënyrat si duhet planifikuar puna dhe si duhet punuar me tekstin shkollor; 2) të paraqiten udhëzime dhe orientime të shkurtra, konkrete për trajtimin e situatave, shkrimeve, materialeve, ushtrimeve etj., të tekstit shkollor. Teksti për mësuesin/en të ndihmojë që ai/ajo të menaxhojë punën si dhe të shërbejë për përdorimin e tekstit shkollor si mjet orientues për organizimin e procesit të nxënies, në kontekstin e qasjes që bazohet në kompetenca.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
13.1	Pjesë e tekstit shkollor është udhëzuesi për mësuesin/en, që ndihmon se si ai/ajo mund të veprojë me tekstin.					
13.2	Udhëzuesi për mësuesin/en informon në mënyrë të shkurtër e të kapshme për qëllimet, konceptimin didaktik, ndërtimin, pikat kyçe dhe mënyrën si duhet punuar me tekstin shkollor, në kontekstin e qasjes që bazohet në kompetenca.					
13.3	Udhëzuesi për mësuesin/en sugjeron orientime konkrete, të lidhura ngushtë me praktikën, për trajtimin didaktik të secilës temë, nëntemë, faqe, detyrë etj.					
13.4	Udhëzuesi përmban orientime për planifikimin e procesit të nxënies (po qe e mundur, për planin mësimor vjetor dhe atë ditor).					
13.5	Përdorimi i udhëzuesit është i thjeshtë dhe i qartë; ai ndihmon në mënyrë efektive përdorimin e tekstit shkollor në procesin e të nxënies.					

Vlera e standardit 13 = $\{[13.1 + \dots + 13.5] : 5\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 14: Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor

Qëllimet: Teksti shkollor të shoqërohet me materiale pune (detyra, sugjerime, ushtrime, fletë pune, antologji etj.) që ndihmojnë dhe nxitin përvetësimin dhe përdorimin e njohurive të reja dhe të kompetencave. Materialet e punës mund të jenë a) të integruara në tekst (p.sh., në formën e udhëzimeve, të detyrave dhe të ushtrimeve në vetë tekstin shkollor); b) të veçanta (p.sh., fletore pune që shoqëron tekstin shkollor, CD që shoqëron fletën e punës etj., të cilat mësuesi/ja mund t'i shtypë, ndoshta edhe t'i modifikojë sipas nevojave të klasës përkatëse); c) në formën e programeve informatike mësimore. Materialet e punës, sugjerimet dhe detyrat të plotësojnë tekstin shkollor. Ato të jenë të larmishme, të shumëllojshme dhe motivuese, të përshtaten me nivele intelektuale të ndryshme dhe me stile të ndryshe të nxëni (njohës/veprues/pamor etj.). Krahasoni dhe standardin 6 (Përpunimi didaktik).

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
14.1	Materialet e punës lidhen tërësisht me përmbajtjen e tekstit shkollor, janë të përfshira sipas rrjedhës logjike dhe plotësohen në mënyrë të ndërsjellë me materialin e tekstit.					
14.2	Teksti shkollor përmban (si pjesë e tekstit apo si pjesë e veçantë) materiale pune (detyra, sugjerime, ushtrime etj.) që i shërbejnë përpunimit, përvetësimit dhe zbatimit efektiv të përmbajtjes së trajtuar.					
14.3	Në aspektin metodik, materialet e punës janë të larmishme dhe të shumëllojshme. Ato janë të përshtatshme dhe për punën me nxënës të veçantë dhe për stile të ndryshme të nxëni (krahasoni me standardet 6.7 dhe 6.12).					

Vlera e standardit 14 = $\{[14.1 + - + 14.3] : 3\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 15: Pilotimi i tekstit shkollor

Qëllimet: *Para certifikimit, teksti shkollor të provohet/të testohet gjerësisht, të paktën për një vit shkollor, në praktikën mësimore të klasave të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme socio-demografike (fshat – qytet, popullsi me arsim të mirë ose të mjaftueshëm). Faza e testimit të ndiqet dhe të vlerësohet shkencërisht. Rezultatet përkatëse të verifikohen dhe të merren parasysh në redaktimin e variantit përfundimtar të tekstit shkollor. Pas pilotimit, teksti shkollor mund të certifikohet nga MAS-i, në qoftë se botuesi ka plotësuar shumë mirë vërejtjet e bëra nga mësuesit dhe nga publiku.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
15.1	Para certifikimit, teksti shkollor është pilotuar sipas dispozitave ligjore, në klasa me kontekste socio-demografike të ndryshme (shihni më lart), gjatë një viti shkollor.					
15.2	Faza e testimit është ndjekur në mënyrë serioze nga agjencitë vartëse të MAS-it dhe nga botuesit dhe është mbyllur me vlerësimin përfundimtar (rezultatet e të cilit janë verifikuar).					
15.3	Rekomandimet e mundshme janë respektuar në redaktimin përfundimtar të tekstit shkollor.					

Vlera e standardit 15 = $\{[15.1 + - + 15.3] : 3\} = \underline{\hspace{2cm}}$

PJESA III

STANDARDET PLOTËSUESE SIPAS LËNDËVE

16. STANDARDET PLOTËSUESE SIPAS LËNDËVE

16.1 Gjuha amtare (gjuha dhe mësimi në pjesët përkatëse të vendit)

16.1.1 Standardi për tekstin shkollor “Abetare”

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.1.1.1	Abetarja siguron (edhe përmes udhëzimeve për mësuesin/en) që fëmijët të kuptojnë, që në fillim të vitit shkollor, natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e shkrimit dhe të teknikave të shkrimit dhe të leximit, si dhe shmang rrezikun e nxënies mekanike të shkrimit të shkronjave.					
16.1.1.2	Rendi sipas të cilit mësohen grafemat (shkronjat) dhe korrelacionet midis fonemave dhe grafemave janë arsyetuar (p.sh., shpeshësia e shkronjave në alfabet).					
16.1.1.3	Leksiku përfshin fjale të thjeshta dhe që janë pjesë e fjalorit të përditshëm (ose të zakonshëm) të fëmijëve.					
16.1.1.4	Abetarja respekton veçoritë gjuhësore të gjuhës shqipe dhe ndikon, me kujdes dhe sistematikisht, që nxënësit/et të njihen me variantin standard (standardi 8).					
16.1.1.5	Abetarja merr parasysh vështirësitë e alfabetizimit (probleme/ngatërrime të fonemave të ngjashme, si <i>ç, q, gj, xh</i> në gjuhën shqipe, të grafemave të ngjashme si <i>b - d</i> , probleme të lidhjes së shkronjave gjatë leximit etj.) dhe ka kujdes të veçantë në fushat përkatëse për të zhvilluar aftësitë e të lexuarit tek nxënësit/et.					
16.1.1.6	Për të lehtësuar dhe për të nxitur procesin e leximit, shkrimet të paktën në dy të tretat e para të abetares, jepen jo në rreshta të zakonshëm, por ndahen, që secili rresht të përmbajë vetëm një njësi sintaksore apo kuptimore.					
16.1.1.7	Abetarja përdor tipa shkronjash që lexohen lehtë , që janë të përshtatshëm për moshën dhe, veçanërisht në fillim, shkronja mjaft të mëdha.					
16.1.1.8	Largësia mes rreshtave është mjaft e madhe, që faqet të jenë të qarta e të kapshme dhe të lehtësohet orientimi i nxënësve/eve në tekst.					
16.1.1.9	Për të ndihmuar zhvillimin gjuhësor të nxënësve/eve, sidomos për fazën fillestare, abetarja ofron shumë fotografi, piktura etj., dhe sugjerime përkatëse me karakter motivues për biseda dhe komunikim gojor.					

16.1.1.10	Abetarja nxit punën e pavarur të nxënësve/eve, p.sh., përmes një numri të caktuar të piktogrameve në lidhje me udhëzime dhe detyra (p.sh., shenja ✍ për foljen shkruaj) dhe me paraqitje tepër të kuptueshme të ushtrimeve.					
16.1.1.11	Abetarja përmban situata të nxëni (detyra/ushtrime shtesë për nxënës/e të niveleve të ndryshme (shihni standardin 6.7).					
16.1.1 .12	Abetarja ka parasysh që njohuritë paraprake të nxënësve/eve në fushën e shkrimit e të leximit, në fillim të klasës së parë, ndryshojnë shumë; për këtë, abetarja ofron ndihmë dhe materiale për dallimet mes nxënësve dhe individualizimin e nxënieve (p.sh., një tabelë me të gjitha shkronjat si mbështetje e të nxënit në mënyrë të pavarur).					
16.1.1 .13	Që në fillim, kompetenca e leximit dhe e shkrimit ushtrohet në mënyrë intensive dhe efektive, përmes situatave të larmishme dhe motivuese për trajnim dhe përsëritje sistematike të grafemave (të korrelacioneve midis fonemave dhe grafemave) të mësuara.					
16.1.1 .14	Abetarja ndihmon aftësitë e dekodimit dhe të kuptuarit. Këtij qëllimi (d.m.th. nxënësit/et edhe të mendojnë për atë që kanë lexuar) i shërbejnë shmangia e teksteve të pakuptueshme, përdorimi i fjalive korrekte nga ana sintaksore (të plotësuara me simbole apo piktura për fjalë që ende s'mund të lexohen), si dhe udhëzimet dhe pyetjet përkatëse.					
16.1.1.15	Abetarja kontribuon, përmes një vargu sugjerimesh dhe detyrash konkrete dhe të përshtatshme për moshën, për zhvillimin e ndërgjegjes gjuhësore dhe të aftësive reflektuese lidhur me gjuhën.					
16.1.1. 16	Abetarja, në materialin për nxënësit/et dhe në librin për mësuesin/en, përmban orientime dhe ushtrime të mjaftueshme për zhvillimin e kompetencave të leximit dhe të shkrimit (përfshirë aspektet motorike të shkrimit)					
16.1.1. 17	Në librin e mësuesit/es përfshihen elemente të rëndësishme si zhvillimi i ndërgjegjes fonologjike, zhvillimi i hershëm i kompetencë për komunikim dhe shprehje etj.					

Vlera e standardit 16.1.1 = {[16.1.1.1 + - + 16.1.1.17] : 17} = ____

16.1.2 “Gjuhë shqipe për shkollën 9-vjeçare”; “Gjuhë shqipe dhe letërsi (bërthamë)”

Shënim: Libri i gjuhës amtare t’u referohet të gjitha fushave të nxënies së gjuhës (lexim, shkrim, të folur, aspekte formale - gramatikë, drejtshkrim - të menduarit rreth gjuhës etj.). Teksti shkollor i gjuhës të kuptohet si mjet ndihmës për të zhvilluar kompetencat gjuhësore të nxënësve/eve në të gjitha këto fusha. Theks i veçantë dhe kryesor t’i vihet zhvillimit të pavarësisë së nxënësve/eve në lidhje me çështjet gjuhësore. Këtij qëllimi, ndër të tjera, t’i shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e nxënies etj., si dhe përgatitja, hartimi dhe paraqitja e lëndës, që të ndihmohet të nxënit përmes veprimit, në mënyrë aktive dhe reflektive, në situata motivuese dhe autentike.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.1.2.1	Teksti shkollor ndihmon ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit në të gjitha aspektet (lexim, shkrim, të folur, gramatikë, drejtshkrim, të menduarit për gjuhën dhe, për aq sa ato janë objekt i mësimi të gjuhës, aspektet në lidhje me mediat - mjete informimi).					
16.1.2.2	Teksti shkollor u ofron nxënësve pjesë ose fragmente interesante, të larmishme dhe tërheqëse nga pikëpamja gjuhësore, nëpërmjet të cilave nxënësi kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon çështje të ndryshme gjuhësore dhe ndërgjegjësohet për pasurinë e gjuhës shqipe.					
16.1.2.3	Përmes situatave të nxënies (shkrimeve, pyetjeve dhe sugjerimeve), teksti shkollor nxit nxënësit/et të formojnë qëndrime të ndërgjegjshme, kritike e reflektuese ndaj gjuhës, në të gjitha fushat e përdorimit të saj, duke zhvilluar dhe duke përforcuar kompetencat e tyre.					
16.1.2.4	Teksti shkollor respekton pasurinë dialektore të shqipes, i përmbahet gjuhës standarde dhe krijon mundësi që nxënësit ta njohin dhe ta zotërojnë atë.					
16.1.2.5	Në materialet, në sugjerimet dhe në detyrat, teksti shkollor u referohet botës reale dhe mjedisit gjuhësor të nxënësve/eve si dhe situatave autentike nga jeta e tyre.					
16.1.2.6	Teksti shkollor nxit pavarësinë e nxënësve/eve, me situata që lejojnë të ndërtohen shkathhtësi dhe teknika pune për përdorimin e gjuhës dhe të menduarin për çështjet gjuhësore.					
16.1.2.7	Teksti shkollor përmban situata tërheqëse dhe motivuese, në sasi të mjaftueshme për moshën përkatëse, me të cilat arrihen,					

	thellohen dhe zbatohen me sukses dhe në mënyrë të larmishme, rezultatet e të nxënit.						
16.1.2.8	Teksti shkollor përmban situata të nxëni që ndihmojnë të nxënit përmes veprimit, zbulimit, eksperimentit; situata që lidhen me nxënien e gramatikës në kontekste vepruese ose me hartimin apo përpunimin e shkrimeve; situata që lidhen me nxënien e gjuhës standarde (krahasime me dialektin, hulumtim nga ana e nxënësve/eve etj.).						
16.1.2.9	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punën me nxënës të veçantë dhe për nxënie individuale, duke ofruar situata në nivele të ndryshme, të diferencuara sipas vështirësisë.						
16.1.2.10	Teksti shkollor ofron teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e rezultateve të nxënies (vetëkontrolli i nxënësve/eve, kudo ku është i mundur, por edhe në tekstin për mësuesin/en).						
16.1.2.11	Situata e të nxënit (detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet dhe trajnimet) në tekstin shkollor, nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.						
16.1.2.12	Teksti shkollor i ofron mundësi dhe situata të nxëni që nxënësit të respektojnë larminë gjuhësore, si dhe të krahasojnë gjuhën shqipe me gjuhët e tjera që mësojnë në shkollë ose jashtë saj.						
16.1.2.13	Teksti shkollor respekton parimin e integritetit mes gjuhës së folur, të lexuarit, të shkruarit dhe njohurive nga sistemi gramatikor i gjuhës shqipe.						
16.1.2.14	Teksti shkollor siguron integrim in mes gjuhës shqipe dhe fushave të tjera të të nxënit/ lëndëve si: historia, gjeografia, artet etj.						
16.1.2.15	Teksti shkollor përmban situata (sugjerime dhe pikënisje) që e aftësojnë nxënësin/en të integrojë burimet e ndërtruara dhe të shfrytëzojë kompetencat gjuhësore.						
16.1.2.16	Teksti mësimor ofron tekste ose fragmente leximi nga pjesa përfaqësuese e letërsisë shqipe dhe ajo botërore, sipas raporteve të rekomanduara në program.						
16.1.2.17	Teksti shkollor u referohet masmediave dhe mjeteve elektronike (televizor, kompjuter, internet, <i>e-mail</i> , <i>SMS</i> etj.), duke integruar sugjerime dhe detyra të lidhura me to (p.sh., për gjuhën e veçantë të <i>SMS</i> -ve, anglicizmat në gjuhën e sotme, dallimet mes <i>e-mail</i> -eve dhe letrave tradicionale etj.).						

Vlera e standardit 16.1.2 = $\{[16.1.2.1 + - + 16.1.2.17] : 17\} = \underline{\hspace{2cm}}$

16.1.3. Standardi për tekstet shkollore të gjuhëve të huaja

Shënime : Në lëndën “Gjuhë e huaj” të përdoren: a) tekstet origjinale të gjuhëve të huaja, b) tekstet për mësimin e gjuhëve të huaja me autorë shqiptarë dhe c) metodat online të mësimin të gjuhëve të huaja.

Për tekste dhe metoda origjinale të huaja në trajtë linje të gjuhëve anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht të përdoret standardi evropian nga klasat III-XII (moshat 9-18 vjeç), nga klasa VI-XII (moshat 12-18 vjeç) dhe nga klasat X-XII (moshat 15-18 vjeç).

Kurrikula e gjuhës së huaja të realizojë nivelin B₂, në ndërtimin e katër kompetencave të domosdoshme për përvojësimin e gjuhës së huaj sipas Kuadrit Europian i Përbashkët i Referencave për Gjuhët. Teksti shkollor për gjuhët e huaja të ketë përmbajtje të integruara që zhvillojnë katër kompetencat e nxënësve për komunikim dhe ndërveprim mes zhvillimit të shkathtësive përkatëse. Për sa i përket didaktikës, zhvillimi i nxënësve/eve duhet ndjekur në mënyrë sistematike, hap pas hapi, prej së thjeshtës deri te dukuritë komplekse, me situata tërheqëse të nxëni (informacion, detyra, ushtrime etj.) që sigurojnë përsëritjen, thellimin dhe zbatimin e kompetencave të fituara.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.1.3.1	Përmbajtja e tekstit shkollor është e afërt me jetën, mbështetet në realitet dhe u intereson nxënësve/eve.					
16.1.3.2	Përmbajtja e tekstit shkollor, struktura dhe koncepti didaktik i tij (përfshirë temat, detyrat, pyetjet, ushtrimet) janë në funksion të zhvillimit të kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit në gjuhën e huaj.					
16.1.3.3	Në tekstin shkollor, respektohen dhe zhvillohen në mënyrë të baraspeshuar shkathtësitë e komunikimit: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor.					
16.1.3.4	Përmbajtjet e sistemit gjuhësor ofrohen, duke pasur parasysh moshën dhe kompetencat psikofizike të nxënësve/eve.					
16.1.3.5	Teksti shkollor ofron mundësi që nxënësit/et të kuptojnë përmes të dëgjuarit, të shprehur lirshëm dhe të kuptohen. Teksti shkollor ofron tema përmes të cilave nxënësit/et pasurojnë dhe thellojnë në mënyrë sistematike fjalorin e tyre me fjalë dhe shprehje të reja.					

16.1.3.6	Teksti shkollor ofron shkrime përmes të cilave nxënësit/et, duke lexuar, marrin dhe kuptojnë informacione të ndryshme për gjuhën dhe kulturën përkatëse.						
16.1.3.7	Teksti shkollor kultivon të lexuarit shprehës (ekspresiv), përmes elementeve gjuhësore si intonacioni, ritmi, melodia, timbri, shenjat e pikësimit.						
16.1.3.8	Teksti shkollor ofron situata të nxëni ku nxënësit/et zhvillojnë shkathtësitë e të shkruarit drejt dhe të kuptueshëm.						
16.1.3.9	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (shkrime, tema dhe detyra) nga lëndët e tjera, në kuadër të programeve përkatëse.						
16.1.3.10	Teksti shkollor ,përmes gjuhës së tij, të fotografive dhe të ilustrimeve, ndihmon barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, tolerancën dhe kultivon edukimin ndërkulturor.						
16.1.3.11	Teksti shkollor kontribuon në njohjen e kulturës së vendit përkatës, në raport me aspektet e ndërsjella kulturore.						
16.1.3.12	Teksti shkollor ofron situata për të nxënë në mënyrë sistematike, që lehtësojnë komunikimin ndërkulturor.						
16.1.3.13	Teksti shkollor ofron shkrime, tema dhe detyra interesante që nxitin dëshirën e nxënësit/es për të nxënë gjuhën e huaj.						
16.1.3.14	Teksti shkollor paraqet situata (shembuj, ushtrime, pyetje dhe detyra) që ndihmojnë punën e pavarur dhe aktive të nxënësve/eve në procesin e të nxënit.						
16.1.3.16	Teksti shkollor nxit nxënësit/et për bashkëpunim dhe për punë në grup, që të përfshihen nxënësve/eve në veprimtaritë e planifikuara për nxënien ndërvepruese.						
16.1.3.16	Teksti shkollor ofron situata (shembuj, ushtrime, pyetje) që zhvillojnë imagjinatën dhe krijimtarinë e nxënësve/eve.						
16.1.3.17	Teksti shkollor jep shembuj për mënyrën e të nxënit, që nxënësi/ja të përjetojë atë që nxë dhe të reflektojë përmes lojës ose roleve të ndryshme, në klasë dhe në jetën e përditshme.						
16.1.3.18	Temat, detyrat dhe ushtrimet në tekstin shkollor janë të renditura në shkallë të ndryshme të vështirësisë, duke filluar nga të thjeshtat, tek ato më të vështira.						
16.1.3.19	Teksti shkollor shoqërohet me fjalor, fletore pune etj., që nxënësit/et të përvetësojnë gjuhën më lehtë						
16.1.3.20	Teksti shkollor ofron detyra, ushtrime etj., të mjaftueshme që garantojnë përsëritjen, thellimin sistematik, vlerësimin dhe vetëvlerësimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.						

Vlera e standardit 16.1.3 = {[16.1.3.1 + - + 16.1.3.20] : 20} = ____

16.1.4. Gjuha shqipe për pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë

Qëllimet: Teksti shkollor i gjuhës shqipe për pakicat kombëtare të ketë përmbajtje të integruara që zhvillojnë kompetencat e nxënësve për komunikim dhe ndërveprim, përmes zhvillimit të shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit si dhe të kuptuarit e sistemit gjuhësor përmes përdorimit. Teksti shkollor të ketë situata me përmbajtje ndërlëndore dhe ndërkulturore, duke pasur parasysh momente të veçanta (festat e kombëtare, festat fetare). Teksti shkollor të reflektojë shembuj pozitiv, përmes të cilëve bartet respekti për kultura dhe për popuj të ndryshëm të botës. Teksti shkollor t'i përgjigjet moshës së caktuar, duke përfshirë metodologjinë bashkëkohore të përdorimit të tij. Teksti të sjellë kënaqësi te nxënësit/et, duke i nxitur për studime të mëtejme për gjuhën shqipe.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.1.4.1	Teksti shkollor përmes përdorimit ndihmon në mënyrë efektive ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha aspektet: dëgjim, të folur, lexim, shkrim dhe sistem gjuhësor.					
16.1.4.2	Teksti shkollor zhvillon të menduarit për gjuhën, aspektet e komunikimit, korrelacionin e gjuhës amtare me gjuhën shqipe dhe krahasimin me të.					
16.1.4.3	Teksti shkollor shoqërohet me figura, fotografi, pamje nga jeta aktuale dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë dhe shkrime të shkurtra që zgjojnë interesimin dhe motivojnë nxënësit/et të merren me gjuhën shqipe në mënyrë vepruese, hulumtuese dhe argëtuese.					
16.1.4.4	Teksti shkollor mban parasysh veçoritë gjuhësore të grupeve etnike, në funksion të integritetit dhe të krahasimit të kulturave, për edukimin me frymën e tolerancës, të respektit dhe të komunikimit ndëretnik.					
16.1.4.5	Teksti shkollor është shkruar me shkrim të lexueshëm e të përshtatshëm nga ana tipografike, veçanërisht në fillim, me shkronja të mëdha.					
16.1.4.6	Teksti shkollor përfshin situata dhe ushtrime të përshtatura për moshën e nxënësit/es, si dhe trajton tema tërheqëse dhe të zbatueshme në komunikimin e përditshëm.					
16.1.4.7	Teksti shkollor është i përshtatshëm për mësim individual dhe përmban figura të kuptueshme, vizatime, fotografi, detyra dhe ushtrime të ndryshme për nivelin përkatës. Këto janë të					

	klasifikuara sipas vështirësisë dhe të shoqëruara gjithmonë me fjalorin përkatës.						
16.1.4.8	Teksti shkollor përmban elemente nëpërmjet të cilave synohet që nxënësit/et të njihen me ligjshmëritë themelore të gjuhës letrare, të krijimtarisë letrare dhe të krijimtarisë kulturore të vendit.						
16.1.4.9	Teksti shkollor nxit nxënësit/et të përdorin me kënaqësi gjuhën shqipe edhe në kontekstin edukativ e ndërkulturor.						
16.1.4.10	Teksti shkollor përmban situata që përputhen me njohuritë paraprake të gjuhës amtare dhe me njohuritë e reja të gjuhës shqipe, përfshirë krahasimin e fjalëve, të dialekteve dhe të kulturave të ndryshme.						
16.1.4.11	Teksti shkollor paraqet situata që nxitin mendimin, krijimtarinë dhe kureshtjen e nxënësit/es për të punuar në mënyrë të pavarur dhe ndërvepruese, p.sh., piktogramet, vizatime për plotësim, udhëzime të kapshme për moshën e nxënësit/es.						
16.1.4.12	Teksti shkollor ofron mundësi dhe teknika përmes të cilave nxënësit/et mund të vetëvlerësohen për arritjet në zotërimin e gjuhës shqipe.						
16.1.4.13	Teksti shkollor integron edhe pjesë nga lëndët e tjera (histori, gjeografi, shkencë etj.)						
16.1.4.14	Teksti shkollor përmban materiale shtesë si fletë pune, teste, etj., për testimin në fund të kapitullit të caktuar.						
16.1.4.16	Teksti shkollor përmban detyra dhe udhëzime lidhur me shfrytëzimin e burimeve të sofistikuar të të nxënësit të gjuhës, siç janë televizori, kompjuteri, interneti, dhe shoqërohet me fjalorth etj.						
16.1.4.17	Teksti shkollor përfshin udhëzime dhe sugjerime të punës së mësuesit/es me librin.						

Vlera e standardit 16.1.4 = $\{[16.1.4.1 + \dots + 16.1.4.17] : 17\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 16.4. Matematika

Qëllimet: Standardi dhe treguesit përkatës pasqyrojnë konceptin aktual shkencor – didaktik, të njohur gjerësisht, që të nxënit në lëndën matematikë nuk kufizohet në numërimin dhe në njehsimin, por përfshin një fushë të gjerë (kuptimi i numrave, i operacioneve dhe i procedurave matematikore, i mënyrave të ndryshme të llogaritjes, i matjeve, i përdorimeve praktike të matematikës etj.). Teksti shkollor të lozë rolin e mjetit që mundëson ndërtimin/zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave matematikore nga nxënësit/et dhe të zhvillojë pavarësinë e tyre për të trajtuar situata reale. Këtij qëllimi t'i shërbejnë, ndër të tjera, situatat matematikore, udhëzimet për procedurat e të nxënit etj., si dhe përgatitja, hartimi dhe paraqitja e situatave motivuese dhe origjinale me të cilat nxënësit/et ndërveprojnë në mënyrë, aktive, krijuese dhe reflektuese për ndërtimin e kompetencave matematikore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.4.1	Ndërtimi, struktura e tekstit shkollor dhe e udhëzuesit të mësuesit/et janë të qartë e të kapshëm, lejojnë orientim të shpejtë dhe të lehtë në të.					
16.4.2	Formatet, mënyrat dhe tipat e situatave të nxënies, që paraqesin çështje dhe detyra matematikore, janë të thjeshtë, të saktë dhe koherentë.					
16.4.3	Gjuha e përdorur në udhëzimet dhe në situatat e nxënies (llogaritjet/detyrat etj.) është e thjeshtë dhe e orientuar drejt gjuhës së përditshme (në trajtën standarde); teksti shkollor u shmanget fjalëve të rralla dhe ndërtimeve sintaksore të pazakonshme.					
16.4.4	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e kompetencave matematikore (zgjidhja problemore në matematikë, arsyetimi dhe vërtetimi matematik, të menduarit dhe komunikimi matematik, lidhja konceptuale, modelimi matematik dhe përdorimi i teknologjisë në matematikë).					
16.4.5	Kuptimi/koncepti i numrave dhe i bashkësive matematikore, si dhe kuptimi i lidhjeve/relacioneve, i operacioneve, i analizave etj., ndërtohen dhe zhvillohen me kujdes, që nxënësit/et të jenë sa më aktivë dhe të mund të veprojnë vetë.					
16.4.6	Teksti shkollor ofron situata të nxëni (materiale, sugjerime dhe ushtrime) për secilën fazë, fushë dhe përmasë të nxënies.					
	Në detyrat dhe sugjerimet, teksti shkollor u referohet, atje ku					

16.4.7	është e mundur, dukurive që gjenden në mjedisin real dhe në botën e nxënësve/eve.						
16.4.8	Teksti shkollor u paraqet nxënësve/eve probleme dhe metoda matematikore interesante, tërheqëse, duke ofruar mundësi dhe sugjerime për të nxënë në mënyrë kritike, kërkuese dhe të pavarur.						
16.4.9	Teksti shkollor, përmes situatave të nxënies, nxit te nxënësit/et qëndrim të ndërgjegjshëm, kritik dhe reflektues ndaj matematikës në fushat e përdorimit të saj.						
16.4.10	Teksti shkollor zbaton parimet bashkëkohore të didaktikës së matematikës, si të nxënit në mënyrë aktive, ndërvepruese, vetëvepruese dhe zbuluese, orientim drejt procesit (jo rezultatit) etj.						
16.4.11	Teksti shkollor zhvillon kompetencat e nxënësve/eve, duke u parashtruar detyra "të hapura", detyra me më shumë se një rrugë zgjidhjeje, ose duke i nxitur të përshkruajnë rrugë e ndjekur dhe të përdorin strategji vetjake etj.						
16.4.12	Teksti shkollor mundëson të nxënit në mënyrë të pavarur, p.sh., përmes formulimeve të thjeshta e të kapshme të detyrave (duke përdorur simbole të kuptueshme) dhe përmes situatave (tipave dhe formateve) të përdorura disa herë.						
16.4.13	Teksti shkollor ofron dije procedurore, strategji, ndihmë dhe teknika, lidhur me hapësirat e ndryshme të veprimit dhe të mendimit në fushën e matematikës.						
16.4.14	Teksti shkollor përmban, në sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, situata tërheqëse dhe motivuese në të cilat nxënësit ndërtojnë/demonstrojnë kompetencat matematike.						
16.4.15	Teksti shkollor përmban sugjerime dhe pikënisje për nxënie që nxitin burimet e nxënësve/eve, sidomos përmes sugjerimeve për integrimin dhe shfrytëzimin e njohurive matematikore (të ndërtruara tashmë ose njohuri jashtëshkollore).						
16.4.16	Situatat e nxënies (informacioni, detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet dhe trajnimet), kudo ku është e mundur, nxitin ndërveprimin e nxënësve/eve.						
16.4.17	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar dhe për mësim individual, duke ofruar detyra dhe ushtrime me nivele të ndryshme, të diferencuara sipas vështirësisë dhe sipas kërkesave.						
16.4.18	Në rastin e detyrave/ushtimeve me nivele të ndryshme (në kuptimin e punës së diferencuar), shkallët/nivelet e						

	vështirësisë janë shënuar në mënyrë të kapshme/të dallueshme, që nxënësit/et të mund të orientohen në mënyrë të pavarur.					
16.4.19	Teksti shkollor krijon/tregon teknika dhe mënyra për vlerësimin ose vetëvlerësimin e rezultateve të nxënies (për vetëkontrollin e nxënësve/eve, kudo ku është i mundur, por edhe tek udhëzimet për mësuesin/en).					
Tregues të veçantë për tekstet e matematikës së arsimit fillor						
16.4.20	Përmes udhëzimeve, teksti shkollor siguron që fëmijët të kuptojnë herët natyrën (strukturën, ndërtimin), funksionet dhe mundësitë e matematikës. Mbi bazën e këtij kuptimi, proceset e të nxënies në lëndën "Matematikë" nxiten së brendshmi dhe shmangin të nxënies mekanik.					
16.4.21	Informacioni dhe numrat janë shkruar me shkrim që lexohet mirë e të përshtatshëm nga ana tipografike, me shkronja mjaft të mëdha dhe me largësi të mjaftueshme mes rreshtave; kjo për të lehtësuar orientimin e nxënësve/eve në secilën faqe.					
16.4.22	Për fazën fillestare, kur nxënësit/et nuk zotërojnë ende të gjithë numrat dhe shkronjat, teksti shkollor ofron shumë fotografi, piktura etj., si dhe sugjerime përkatëse, që nxitnin nxënësit/et të interesohen, të mendojnë, të komunikojnë me njëri-tjetrin për dukuritë matematikore.					
16.4.23	Teksti shkollor ofron situata të nxënies, materiale dhe sugjerime të mjaftueshme për të zhvilluar, njëkohësisht me kompetencat matematikore, edhe shkathtësi dhe strategji të posaçme të leximit dhe të shkrimit, që janë me rëndësi për lëndën e matematikës.					

Vlera e standardit 16.4 = $\{16.4.1 + - + 16.4.19\} : 19 = \underline{\hspace{2cm}}$

Për tekstet e matematikës së arsimit fillor:

Vlera e standardit = $\{16.4.1 + - + 16.4.23\} : 23 = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 16.5. Shkencat e natyrës

Qëllimet: *Tekstet shkollore të fushës së shkencave të natyrës të luajnë rolin e informuesit dhe të mjetit ndihmës që mundësojnë zhvillimin e njohurive dhe të kompetencave të nxënësve/eve për studimin e aspekteve të ndryshme të natyrës. Ato të ndihmojnë nxënësit/te të krijojnë vetëdijen për ndërtimin dhe funksionimin e organizmave të gjallë, për njohjen e ligjeve themelore të proceseve jetësore, për vërtetimin në natyrë të dukurive fizike dhe kimike, për unitetin e materies dhe për pozitën e Tokës në gjithësi. Tekstet shkollore të ndihmojnë nxënësit/et në punën e pavarur teorike, eksperimentale dhe praktike, në zhvillimin e shkathtësive dhe të shprehive për të matur, për të përpunuar të dhëna eksperimentale dhe për t'i zbatuar në situata konkrete, për zhvillimin e mendimit kritik, si dhe për të përdorur literaturë dhe burime të tjera për nxënie. Këtij qëllimi t'i shërbejnë udhëzimet e tekstit shkollor në lidhje me strategjitë e të nxënësve, si dhe përgatitja, hartimi dhe paraqitja e situatave të reja, që ato të ndihmojnë dhe të nxitin të nxënësve aktiv përmes ndërveprimit.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.5.1	Ndërtimi i situatave të nxënësve dhe struktura didaktike e tekstit shkollor janë të qarta, të kuptueshme, lejojnë orientimin e lehtë në tekst dhe zbatimin e lëndës së trajtuar gjatë mësimit.					
16.5.2	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
16.5.3	Teksti shkollor u referohet arritjeve të reja shkencore.					
16.5.4	Në tekstin shkollor, formulimi i formulave, i veprimeve matematike dhe i analizave numerike, ndërtohet me anën e situatave dhe zhvillohet në mënyrë të kujdesshme, jo imponuese, që nxënësit/et të jenë sa më aktivë dhe të mund të veprojnë të pavarur.					
16.5.5	Teksti shkollor ofron situata të nxënësve (materiale, sugjerime, prova, ushtrime, detyra, eksperimente) për secilin nivel (taksonomik) të njohjes.					
16.5.6	Në fund të çdo njësie të tekstit shkollor, kontrollohet realizimi i rezultateve të nxënësve, për secilin nivel, me kërkesa të përcaktuara që u drejtohen nxënësve/eve.					
16.5.7	Teksti shkollor u ofron nxënësve/eve situata të nxënësve (problema, metoda njehsimi, zgjidhje interesante, tërheqëse), por dhe mundësi e sugjerime të ndryshme për të nxënë të pavarur, nëpërmjet kërkimit e zbulimit.					

16.5.8	Në tekstin shkollor paraqiten ecuri të ndryshme deri tek i njëjti përfundim, përfundim i nxjerrë nga prova, demonstrime, matje eksperimentale, vrojtime dhe zgjidhje të detyrave me ecuri të ndryshme, që nxitin strategji vetjake të nxënies.					
16.5.9	Teksti shkollor, përmes demonstrimeve, eksperimenteve, matjeve, vrojtimeve në terren, vrojtimeve me teleskop në qiell të hapur dhe detyrave tipike u ofron nxënësve/eve mundësi që të nxënë në mënyrë të pavarur, në përputhje me moshën e tyre.					
16.5.10	Teksti shkollor përmban në sasi të mjaftueshme ushtrime, detyra, prova, demonstrime, eksperimente që nxitin dhe mundësojnë thellimin dhe zbatimin në jetën e përditshme të njohurive dhe të kompetencave të fituara.					
16.5.11	Në tekstin shkollor, detyrat, sugjerimet për punë të mëtejshme, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet nxitin komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.					
16.5.12	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar me nxënësit/et dhe për nxënie individuale, pasi ofron detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vrojtime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
16.5.13	Teksti shkollor u ofron nxënësve/eve, teknika dhe mënyra për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të nxënies.					
16.5.14	Ngarkesat (vëllimi) e njësive mësimore në tekstin shkollor janë të baraspeshuara mes tyre, në përputhje me lëndën dhe me kompetencat e nxënësve/eve.					
16.5.15	Në fund të tekstit shkollor, është fjalori i termave të koncepteve kryesore të trajtuara, si dhe indeksi i termave shkencorë.					
16.5.16	Në tekstin shkollor, detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vrotimet në qiell u referohen, vazhdimisht dhe me kuptim, dukurive natyrore që gjenden në mjedisin jetësor dhe në botën e nxënësve/eve.					
16.5.17	Teksti shkollor, përmes materialeve, sugjerimeve, ushtrimeve, detyrave, provave, demonstrimeve dhe eksperimenteve të përshtatshme, nxit zhvillimin e kompetencave lëndore.					
16.5.18	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit.					
16.5.19	Në tekstin shkollor, korniza e përmbajtjes e madhësive fizike, e simboleve dhe e formulave kimike, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar të njësive (SI) dhe rregullave të IUPAC-ut.					

16.5.20	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e sigurimit teknik gjatë provave, demonstrimeve, eksperimenteve dhe vrojttimeve në qiell, si dhe lista e materialeve të rrezikshme.					
Treguesit për tekstet e shkencave të integruara në lëndën "Dituri natyre"						
16.5.21	Teksti shkollor "Dituri natyre", në të cilin janë të integruara shkencat e natyrës, siguron që fëmijët të kuptojnë natyrën, proceset fizike, kimike dhe biologjike, mjedisin që i rrethon, ndërtimin dhe mbrojtjen e tij.					
16.5.22	Ngarkesat (vëllimet) e njërive mësimore në tekstin shkollor "Dituri natyre" janë të baraspeshuara dhe nuk sjellin monotoni.					
16.5.23	Teksti shkollor "Dituri natyre" ofron shumë fotografi dhe piktura që nxitin nxënësit/et të interesohen, të mendojnë e të komunikojnë me njëri tjetrin për mjedisin që i rrethon, për natyrën dhe për dukuritë natyrore.					
16.5.24	Teksti shkollor "Dituri natyre" ofron materiale të bollshme dhe sugjerime të mjaftueshme për të zhvilluar te nxënësit/et shkathtësitë e interpretimit të drejtë të dukurive natyrore, të proceseve fizike, kimike dhe biologjike që lidhen me to, të ndërtimit të tokës, të botës bimore dhe shtazore, të burimeve të energjisë, ajrit, ujit, të orientimit në hapësirë dhe të trupave të sistemit diellor.					

Vlera e standardit 16.5 = $\{[16.5.1 + - + 16.5.20] : 20\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Për tekstin shkollor "Dituri natyre":

Vlera e standardit = $\{[16.5.21 + - + 16.5.24] : 4\} = \underline{\hspace{2cm}}$

Standardi 16.6. Shkencat shoqërore

16.6.1 Historia

Qëllimet: *Tekstet shkollore të historisë të jenë pikëmbështetje transparente për çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë siç duhet nxënësit/et; t'u ndihmojnë nxënësve/eve që, duke kuptuar zhvillimet e proceseve dhe të dukurive të shoqërisë njerëzore, të krijojnë vetëdije historike; tekstet shkollore të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave të tyre për të njohur dhe për të zbatuar procedura hulumtimi, për të gjykuar në mënyrë kritike për burime dhe pikëpamje të ndryshme dhe për t'i zbatuar ato kur marrin vendime. Tekstet shkollore të nxitin zhvillimin e nxënësve/eve si qytetarë aktivë dhe të ndërgjegjshëm në ndërtimin e një shoqërie demokratike.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.6.1.1	Teksti shkollor, sa i përket aspekteve didaktike, merr parasysh përvojat dhe njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve.					
16.6.1.2	Teksti shkollor krijon lidhje me jetën e përditshme të nxënësve/eve.					
16.6.1.3	Teksti shkollor nxit të nxënësit e qartë dhe ndërlidh përmbajtjen me kompetencat kyçe dhe të fushës.					
16.6.1.4	Struktura e ndërtimit të tekstit shkollor dhe e udhëzuesit të mësuesit/es është e qartë, e kapshme dhe lejon orientim të shpejtë, të lehtë dhe zbatimin aktiv e njohurive të trajtuara gjatë procesit të nxënies.					
16.6.1.5	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin e kompetencave të nxënësve/eve për të qenë qytetarë të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e shoqërisë demokratike.					
16.6.1.6	Përmes materialeve, pyetjeve dhe sugjerimeve, teksti shkollor nxit nxënësit/et të kultivojnë vlera si mirëkuptimi, bashkëpunimi, toleranca, paqja, respektimi i të drejtave të njeriut si faktorë vendimtarë pajtimi, mirënjohjeje, mirëkuptimi e besimi të ndërsjellë midis njerëzve e popujve.					
16.6.1.7	Teksti shkollor respekton veçantitë etnike e kulturore të Shqipërisë dhe kontribuon në kultivimin dhe vënien në pah të identitetit individual, kolektiv e kombëtar, nëpërmjet njohjes së trashëgimisë historike e kulturore lokale, rajonale, kombëtare, europiane e botërore.					
	Teksti shkollor pasqyron larminë, kohezionin dhe integrimin e					

16.6.1.8	grupeve dhe të kategorive shoqërore (gjinore, etnike, racore, fetare etj.), si dhe konkretizon një qasje ndërkulturore që i sheh ngjarjet historike nga kënde shikimi të ndryshëm.						
16.6.1.9	Teksti shkollor përkrah pavarësinë e nxënësve/eve, duke ofruar strategji, teknika të nxëni dhe veprimi, në lidhje me çështjet historike dhe të menduarit historik.						
16.6.1.10	Teksti shkollor përmban në sasi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për moshën përkatëse, ushtrime dhe trajnime tërheqëse dhe motivuese që ndikojnë në përdorimin e burimeve për njohjen e fakteve historike dhe për nxënien e tyre në mënyrë kritike dhe analitike.						
16.6.1.11	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar, përmes të cilës nxënësit/et ndërmarrin (sipas nivelit, mundësive dhe rrethanave) kërkime individuale dhe nxitin kërkshërinë dhe frymën vetëvepruese në vjeljen e të dhënave dhe në krijimin e mendimit të tyre përgjithësues.						
16.6.1.12	Hartat, ilustrimet, fotot, karikaturat, tabelat statistikore, si mjete konceptuese të tekstit, nxitin procesin e të kuptuarit, analizë e ngjarjeve dhe të dukurive historike, njëkohësisht, zhvillojnë komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve (krahaso standardin 3).						
16.6.1.13	Teksti shkollor krijon lidhje harmonike ndërmjet përdorimit të praktikave dhe të metodologjive bashkëkohore, TIK-ut multimedial, të muzeve dhe të arkivave.						
16.6.1.14	Teksti shkollor nxit përdorimin e mundësive edukative që ofrojnë fushat e të nxënit, duke vendosur lidhje me letërsinë, gjeografinë, shkencat shoqërore filozofinë, artet, përfshirë dhe lëndët e shkencave ekzakte.						
16.6.1.15	Teksti shkollor ofron mënyra e teknika për (vetë) vlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe të rezultateve të nxënies nga nxënësit/et, kudo ku është e mundur (edhe udhëzuesi për mësuesin/en jep udhëzime e sugjerime përkatëse)						

Vlera e standardit 16.6.1 = {[16.6.1.1 + - + 16.6.1.15] :15} = ____

16.6.2 Qytetaria

Qëllimet: Teksti shkollor i qytetarisë të nxitë zhvillimin e fëmijëve e të rinjve/të rejave si qytetarë të ndërgjegjshëm për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, të pajisur me njohuri, me vlera dhe me qëndrime të qytetarisë demokratike, paqësorë, tolerantë, të hapur dhe të vullnetshëm për të marrë pjesë në jetën qytetare të vendit dhe për të kontribuar në ndërtimin e shoqërisë demokratike, ku respektohen të drejtat e secilit, pa marrë parasysh përkatësinë gjinore, kombëtare, etnike, fetare dhe racore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.6.2.1	Teksti shkollor ndihmon zhvillimin dhe zgjerimin e kompetencave personale dhe qytetare, në të gjitha fushat e nxënies së edukatës qytetare.					
16.6.2.2	Teksti shkollor është koherent sa i takon konceptimit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës së paraqitjes së çështjeve të edukimit qytetar.					
16.6.2.3	Format dhe përmbajtjet e situatave të nxënies janë të qarta, funksionale dhe koherente me qëllimet e lëndës të parashikuara në programin mësimor.					
16.6.2.4	Ndërtimi dhe struktura e tekstit shkollor dhe e udhëzuesit të mësuesit/es janë të qarta, të kapshme dhe lejojnë orientimin e lehtë dhe zbatimin e nxënieve të trajtuara.					
16.6.2.5	Ilustrimet, fotografitë, statistikat, grafikët, kutitë/insertet ose komentet e veçanta japin informacion plotësues që ndihmojnë procesin e të nxënimit përmes komunikimit dhe ndërveprimit.					
16.6.2.6	Teksti shkollor ndihmon kuptimin e qytetarisë demokratike, duke krijuar hapësirë për punë të pavarur dhe duke nxitur kureshtjen për shfrytëzimin e burimeve të shkruara dhe/ose elektronike, ose nga bisedat me qytetarë, me anëtarë ose me drejtues të shoqatave, institucioneve etj.					
16.6.2.7	Teksti shkollor u referohet strukturave, ngjarjeve dhe institucioneve shoqërore dhe u jep mundësi nxënësve/eve të përballen më lehtë dhe të zgjidhin çështje me të cilat merren ata dhe komuniteti ku jetojnë.					
16.6.2.8	Përmes shkrimeve, sugjerimeve dhe detyrave të përshtatshme, teksti shkollor nxit dhe përgatit nxënësit/et për qëndrime të ndërgjegjshme, kritike dhe reflektuese ndaj problemeve shoqërore, për marrjen e përgjegjësisë dhe të detyrave në familje, në shkollë apo në komunitet.					

16.6.2.9	Teksti shkollor, me shpjegime dhe shembuj të përshtatshëm, nxit pjesëmarrjen aktive dhe vendimmarrjen në çështjet që kanë të bëjnë me të mirën dhe interesin personal e publik.					
16.6.2.10	Teksti shkollor përmban informacion mbi vlerat dhe konceptet themelore të qytetarisë, nxit pjesëmarrjen në organizimet e jetës shoqërore dhe komunikimin/ndërveprimin në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.					
16.6.2.11	Teksti shkollor ndikon drejtpërdrejtë ose tërthorazi për edukimin për demokraci dhe vlera të shoqërisë demokratike, për të drejtat njerëzore, për barazi qytetare, për luftë kundër dallimin gjinor, kulturor, gjuhësor, etnik, racor, fetar etj.					
16.6.2.12	Teksti shkollor kultivon qëndrime dhe vlera humane dhe mjedisore, rrit vetëdijen dhe nxit veprime që synojnë ruajtjen e dinjitetit njerëzor dhe të mjedisit.					
16.6.2.13	Teksti shkollor afirmon paqen, tolerancën, mirëkuptimin, komunikimin, dialogun dhe solidaritetin ndërmjet brezave, kulturave, feve, etnive dhe kombeve të ndryshme.					
16.6.2.14	Teksti shkollor promovon vlerat për zhvillimin e identitetit vetjak, për kujdesin dhe ruajtjen e shëndetit nga të gjitha format e rrezikut, nëpërmjet shkathhtësive për jetën, duke gjetur format e parandalimit të konflikteve ose të zgjidhjes paqësore të tyre.					
16.6.2.15	Gjuha e përdorur në situatat e nxënies përshtatet me moshën dhe aftësitë psiko-fizike të nxënësve/eve.					
16.6.2.16	Teksti shkollor jep mundësi dhe ofron mënyra e teknika për vetëvlerësimin e arritjes së qëllimeve dhe rezultateve të nxënies nga nxënësit/et, kudo ku është i mundur (edhe udhëzuesi për mësuesin/en jep sugjerime përkatëse).					

Vlera e standardit 16.6.2 = {[16.6.2.1 + - + 16.6.2.16] : 16} = _____

16.6.3 Shkencat e tjera shoqërore

Qëllimet: Teksti shkollor të përmbajë njohuri themelore dhe thelbësore nga fusha shkencore përkatëse dhe të shpjegojë proceset dhe dukuritë shoqërore, mbështetur në teoritë shkencore të përparuara të fushës përkatëse. Teksti shkollor të përputhet me qëllimet e lëndës përkatëse, duke shmangur njëanshmëritë në paraqitje dhe në interpretime, drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.6.3.1	Teksti u përshtatet aftësive njohëse, njohurive të ndërtuara paraprakisht nga nxënësit, nevojave dhe interesave të nxënësit/es; pamja dhe paraqitja e tekstit shkollor përputhet me moshën e nxënësve/eve për të cilët është konceptuar ai.					
16.6.3.2	Për sa i përket konceptit didaktik, terminologjisë së përdorur dhe mënyrës si paraqiten çështjet e trajtuara, teksti shkollor është koherent dhe përputhet plotësisht me konceptimin e përgjithshëm të qasjes që bazohet në kompetenca dhe me qëllimet e programit përkatës.					
16.6.3.3	Teksti shkollor është strukturuar në përputhje me dijet, me metodologjinë e lëndës përkatëse dhe qartëson çka duhet të nxënë nxënësi/ja (konceptet/metodat etj.) dhe cilat janë rezultatet e të nxënit.					
16.6.3.4	Teksti shkollor kontribuon në zhvillimin e kulturës së nxënies dhe përmban situata të nxëni (materiale, udhëzime, sugjerime dhe nxitje për nxënie të pavarur, informata e të dhëna bibliografike për libra dhe burime plotësuese) për thellimin e njohurive dhe të kompetencave nga lënda përkatëse.					
16.6.3.5	Teksti shkollor nxit interesin për lëndën mësimore, duke krijuar qëndrim pozitiv ndaj përmbajtjes së lëndës, por motivon edhe shkathtësitë e mendimit kritik dhe krijues.					
16.6.3.6	Teksti shkollor zhvillon lidhje të shumëfishta midis koncepteve shkencore e metodologjike dhe ndërlidhet me konceptet e lëndëve të përafërta, si bazë për ndërtimin nga nxënësit të njohurive të reja dhe të kompetencave.					
16.6.3.7	Teksti shkollor mbështetet në teori shkencore dhe në parime morale të kuptueshme dhe të pranueshme, zbatimi i të cilave është në pajtim me shkallën e zhvillimit psiko-fizik të nxënësit/es.					
	Teksti shkollor shpalos ide, vlera dhe parime morale, duke					

16.6.3.8	ndihmuar vetëdijesimin për ndryshimet sociale, kulturore, ekonomike dhe mjedisore që ndërliken me zhvillimin shkencor dhe teknologjik.						
16.6.3.9	Teksti shkollor mbështetet në njohjen dhe në studimin e kushteve të përgjithshme të ekzistencës dhe të zhvillimit të njeriut dhe të shoqërisë njerëzore, të zhvillimit të kulturës së popujve dhe të vendeve të ndryshme, të ruajtjes së mjedisit, të ekosistemeve dhe të biodiversitetit.						
16.6.3.10	Teksti shkollor nxit mendimin të pavarur, kritik dhe krijues, zhvillon shkathtësitë hulumtuese në fushën e lëndës përkatëse dhe ndihmon zhvillimin e cilësive pozitive të personalitetit.						
16.6.3.11	Teksti shkollor nxit qëndrime, sjellje të dobishme dhe funksionale (vetjake dhe kolektive) dhe afirmon frymën e bashkëpunimit, të integritit dhe gjithëpërfshirjes së faktorëve.						
16.6.3.12	Teksti shkollor ndihmon të kuptuarit e proceseve të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ndarjen shoqërore të punës, ekonominë, shtresat dhe lëvizjet sociale, politikën, kohezionin dhe integrimin social, progresin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.						
16.6.3.13	Teksti shkollor shpalos vlerat dhe parimet e demokracisë dhe të sundimit të ligjit dhe mbështet zhvillimin demokratik, pluralist të shoqërisë.						
16.6.3.14	Teksti shkollor u kundërvihet diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe paraqitjes negative të individëve dhe të grupeve shoqërore.						
16.6.3.15	Teksti shkollor afirmon dhe ndihmon njohjen e proceseve integruese europiane, në të gjitha fushat e jetës shoqërore.						
16.6.3.16	Teksti shkollor zhvillon ndjenjën e dashurisë ndaj vendit tonë si bashkësi e qytetarëve të barabartë dhe afirmon njohjen, respektimin dhe hapjen ndaj vlerave të popujve, kombeve dhe kulturave të tjera në Europë dhe në botë.						
16.6.3.17	Hartat në tekstin shkollor janë të lexueshme (kanë madhësinë e duhur për t'u lexuar) dhe kanë kontrast të mjaftueshëm të ngjyrave.						

Vlera e standardit 16.6.3 = $\{[16.6.3.1 + - + 16.6.3.17] : 17\} = \underline{\hspace{2cm}}$

16.7 Muzika

Qëllimet: Teksti shkollor të jetë udhërrëfyes për mësuesin/en e muzikës në realizimin e qëllimeve të fushës “Arte” në nivele/ klasa të ndryshme. Teksti shkollor të jetë mjet i nevojshëm për punë individuale, punë në grup në klasë dhe për punë të pavarur në shtëpi. Teksti shkollor të jetë i plotë, i përdorshëm dhe të shoqërohet me burime muzikore-artistike përkatëse në shtojcën e veçantë (CD, DVD etj.). Teksti shkollor të konceptohet në njësi mësimore të cilat përmbajnë situata (elemente dhe kombinime të veprimtarive kryesore muzikore) që ndihmojnë nxënësin/en të zhvillojë kompetencat e fushës/lëndës si interpretim (këngë dhe lojë në instrumente), krijim muzikor dhe vlerësim i veprave muzikore.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.7.1	Teksti shkollor i përshtatet qasjes që bazohet në kompetenca, përcaktuar nga programi mësimor për klasën përkatëse.					
16.7.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni të përshtatshme nga tri tematikat kryesore muzikore: <i>gjuha dhe komunikimi muzikor, teknika dhe procese muzikore dhe historia, muzika dhe shoqëria</i> , në renditje logjike, sipas niveleve shkollore.					
16.7.3	Përmbajtjet muzikore të tekstit shkollor (shembujt për këndimin dhe dëgjimin e veprave muzikore) u përshtaten nivelit përkatës shkollor dhe aftësive perceptuese e interpretuese të nxënësve/eve në nivelin përkatës.					
16.7.4	Përmbajtjet muzikore të tekstit shkollor zhvillojnë larminë e formacioneve interpretuese (solo, ansambël, orkestrale), format muzikore dhe gjinitë muzikore (muzikë vokale - instrumentale, instrumentale).					
16.7.5	Teksti shkollor respekton llojet e trashëgimisë muzikore popullore nga trevat e Shqipërisë dhe nga gjinitë e ndryshme të krijimtarisë kombëtare, p.sh., këngë, valle, melodi për instrumente popullore nga të gjitha trevat.					
16.7.6	Teksti respekton llojet dhe krijimtarinë botërore muzikore (popullore dhe artistike) të vendeve të ndryshëm, për t'i edukuar dhe përgatitur nxënësit/et me kultura të ndryshme muzikore.					
16.7.7	Radhitja e njësive mësimore në tekstin shkollor, sipas tematikave, është në funksion të ndërtimit të kompetencave muzikore.					
16.7.8	Teksti shkollor përdor ilustrime të përshtatshme që lidhen me situatat e të nxënit, sidomos në nivelet kur nuk parashikohen					

	notat muzikore.						
16.7.9	Teksti shkollor ofron udhëzime të qarta për nxënësit/et dhe mësuesin/en se si të trajtohet dukuria e caktuar muzikore, përmes situatave konkrete: dëgjimi, këndimi, biseda, krijimi etj.						
16.7.10	Teksti shkollor merr parasysh nivelin e nxënësve/eve në klasën përkatëse për sasinë dhe nivelin e vështirësisë së situatave, kur paraqet notat muzikore (p.sh., në tekstet e klasave IV - V, notat shërbejnë vetëm për t'u përdorur nga mësuesi/ja, ndërsa për nxënësit/et ofrohen grafika dhe simbolet e germave muzikore etj.).						
16.7.11	Teksti shkollor ndërlidh situatat muzikore me artet e tjera: artin pamor, letërsinë, filmin, dramën etj.						
16.7.12	Teksti shkollor përmban material muzikor (notat) të përshtatshëm për interpretim (këngë dhe përmbajtje për lojë në instrumentet për fëmijë (instrumentet të ndryshme Orf-i, blokflauti etj.), në përputhje me kompetencat muzikore të nxënësve/eve të klasës përkatëse.						
16.7.13	Teksti shkollor orienton nxënësit/et për punë krijuese të pavarur.						
16.7.14	Teksti shkollor përmban këngë, tekstet e të cilave janë me vlerë të lartë edukative dhe letrare. Teksti i shqipëruar i këngëve të huaja ruan vlerat estetike-letrare të poezisë origjinale.						
16.7.15	Teksti shkollor (edhe CD-ja) përmban shembuj muzikorë që ndihmojnë nxënësit/et: a) të kuptojnë koncepte muzikore si a) lartësia, gjatësia e tingujve; b) të shprehen me lëvizje; c) të vallëzojnë etj.						
16.7.16	Teksti shkollor ofron informacion mbi instrumente të ndryshme muzikore, shoqëruar me pamjet e instrumentit dhe me shembuj të përshtatshëm për dëgjimin e muzikës (CD), për ilustrimin e ngjyrës së tingullit të instrumentit të caktuar.						

Vlera e standardit 16.7 = {[16.7.1 + - + 16.7.16] : 16} = _____

16.8 Arti pamor

Qëllimet: *Qëllimi i tekstit është zhvillimi i aftësive krijuese, komunikuese si dhe perceptimi artistik i botës, përfshirë stilet, teknikat dhe etapat e tjera zhvilluese, sipas didaktikës së lëndës. Natyra e lëndës kërkon rrugë të reja për nxitjen e veprimtarisë krijuese të çdo nxënësi/eje, e cila ndihmon pjesëmarrjen në diskutime, në përshkrime, në analiza dhe në vlerësimin e veprave të ndryshme të historisë së artit dhe të kulturës ose në vlerësimin e krijimeve të shokëve dhe të shoqeve, veprimtari që zhvillohen në grup dhe që edukojnë respektin për mendimin e tjetrit. Treguesit e mëposhtëm të frymëzojnë përdorimin e metodologjive dhe të teknikave të ndryshme krijuese për një tekst shkollor të suksesshëm, që interesimi dhe përkushtimi i nxënësve/eve të sjellë rezultate të dëshiruara në edukimin e tyre artistik dhe kulturor dhe në përgatitjen si qytetarë.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.8.1	Teksti shkollor i përshtatet nivelit arsimor dhe qasjes që përcakton programi mësimor për shkallën përkatëse.					
16.8.2	Teksti shkollor ofron situata të nxëni të përshtatshme për zhvillimin e tri tematikave kryesore: gjuha dhe komunikimi artistik, teknika e procese artistike dhe historia, arti dhe shoqëria, në renditje logjike, sipas niveleve shkollore.					
16.8.3	Teksti shkollor ka ilustrime origjinale të nivelit të lartë, fotografi, riprodhime (të veprave të autorëve) dhe tabela të tjera shpjeguese me grafikë, sipas nivelit dhe klasës.					
16.8.4	Teksti shkollor ka njësi mësimore që, përmes situatave me përmbajtje shkencore të kuptueshme (shembuj, ushtrime dhe formulime praktike) shërbejnë për ndërtimin sistematik të njohurive të reja dhe të kompetencave lëndore.					
16.8.5	Mënyra e paraqitjes së situatave të nxënies dhe e ilustrimeve grafike në tekstin shkollor nxit nxënësit/et për kërkim dhe për krijim, pasi i nxit për sfida dhe sukses në teknikat dhe në disiplinat artistike të pëlqyera prej tyre.					
16.8.6	Teksti shkollor përmban materiale pamore të kuptueshme, të përshtatshme që i nxitin nxënësit/et të bashkëveprojnë, të komunikojnë, të përvetësojnë dhe të transferojnë njohuritë të njëri-tjetri.					
16.8.7	Teksti shkollor përputhet me normat e gjuhës letrare dhe pamore artistike dhe përmban përshkrime/udhëzime tekniko-krijuese.					

16.8.8	Teksti shkollor pasqyron realitetin artistik dhe aspektet historike dhe kulturore të Shqipërisë me riprodhime të veprave të artit dhe me objekte të trashëgimisë kulturore, duke promovuar nxitjen e tolerancës, respektimin e opinioneve estetike dhe kritike të ndryshme.					
16.8.9	Teksti shkollor i shërben formimit të personalitetit krijues të nxënësve/eve, nëpërmjet dijeve për teknikat e larmishme artistike, për gjuhën artistike, për veprat dhe për autorët, për kulturën, për artizanatin dhe për aspekte të tjera.					
16.8.10	Teksti shkollor i orienton nxënësit/et të njohin, të pranojnë dhe të zhvillojnë tolerancën ndaj kulturave të ndryshme, përmes kërkimeve, dialogut të ndërsjellë dhe shkëmbimit të përvojave artistike.					
16.8.11	Teksti shkollor baraspeshon përmbajtjet, shembujt dhe ilustrimet, për të shmangur dallimin gjinor edhe në aspektin e përfaqësimit të autorëve/eve me veprat e përfshira në tekst.					
16.8.12	Teksti shkollor përmban ide për kërkim, rubrika me punime praktike, pyetje dhe detyra tërheqëse, që nxënësit/et të vazhdojnë plotësimin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të sigurt.					
16.8.13	Teksti shkollor udhëzon, nxit dhe plotëson përvetësimin e kompetencave artistike, përmes motivimit për krijime të shumëllojshme vizuale.					
16.8.14	Në tekstin shkollor paraqiten forma, teknika dhe mënyra të punës praktike që sqarojnë hollësisht fazat kërkimore-hulumtuese dhe mundësitë e shumta shprehëse dhe realizuese.					
16.8.15	Teksti shkollor përmban informacione shtesë për zhvillimin e artit, përmes Web-faqeve, lidhjeve elektronike apo CD-ve e DVD-ve.					

Vlera e standardit 16.8 = {[16.8.1 + - + 16.8.15] ;} = _____

16.9 Aftësimi teknologjik (klasat 1 - 5)

Qëllimet: *Tekstet shkollore të jenë bashkëkohore për nga përmbajtja, metodologjia e shtjellimit dhe qasja didaktike / pedagogjike. Ato të përmbajnë materiale, të dhëna dhe metoda të reja pune, që të ndihmojnë nxënësit/et dhe mësuesit/et në përvojën e njohurive dhe të kompetencave për integrim në proceset globale ku përparimet teknologjike janë shtysë e rëndësishme e zhvillimit shoqëror në përgjithësi dhe zhvillimit ekonomik në veçanti.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.9.1	Teksti shkollor u përshtatet nivelit shkollor dhe qasjeve që përcakton kurrikula për këtë nivel (krahasoni standardin e përgjithshëm 1.1-1.3).					
16.9.2	Në tekstin shkollor, përmbajtjet janë aktuale, të bazuara në arritjet më të reja të shkencave natyrore, veçanërisht të shkencave teknike dhe informatike. Idetë, konceptet, eksperimentet, shembujt dhe projektet e punimeve të dorës në tekstin shkollor janë të kapshme dhe të kuptueshme për grup moshën e nxënësve/eve.					
16.9.3	Situatat e paraqitura në tekst, veçanërisht punimet praktike, nxitin dhe zhvillojnë krijimtarinë individuale dhe aftësinë për punë në grup të nxënësve/eve.					
16.9.4	Situatat e shtjelluara në tekstin shkollor janë renditur sipas shkallës së vështirësisë, duke filluar nga më të thjeshtat.					
16.8.5	Projektet e punës së dorës, eksperimentet dhe ushtrimet janë konceptuar dhe strukturuar në situata që zhvillojnë aftësinë e nxënësve/eve për zbatimin në praktikë të njohurive dhe të kompetencave të ndërtuara.					
16.9.6	Përmes përshkallëzimit dhe llojshmërisë të punëve së dorës, teksti shkollor kultivon te nxënësi/ja ndjenjën e efikasitetit të punës dhe të vetëbesimit për arritje të suksesshme.					
16.9.7	Ilustrimet janë të shumta, të sakta, të kuptueshme dhe respektojnë veçoritë e logjikës teknike. Ku është e nevojshme, ilustrimet kanë legjenda shpjeguese të kuptueshme dhe të dallueshme (me numra, shkronja apo ngjyra të ndryshme).					
16.9.8	Teksti shkollor u kushton kujdesin e duhur emërtimeve tekniko-teknologjike bashkëkohore, duke baraspeshuar emërtimet dhe shkurtimet teknike në gjuhën origjinale dhe përkthimit të tyre në gjuhën shqipe.					

16.9.9	Në tekstin shkollor u kushtohet kujdes i veçantë aspekteve të edukimit shëndetësor.					
16.9.10	Ushtrimet dhe punimet praktike zhvillojnë te nxënësit/et ndjenjën për kursim të materialeve që përdoren.					
16.9.11	Në tekstin shkollor i kushtohet vëmendje e veçantë mjedisit, duke e trajtuar shkencërisht. Ndotja lokale dhe globale e mjedisit shtjellohet përmes lidhjes shkak-pasojë të veprimeve të njeriut (ekonomi, industri, energjetikë etj.).					
16.9.12	Teksti shkollor përputhet plotësisht me konceptimin dhe shtjellimin e teksteve të klasave ku zhvillohet lënda “Punë dore”, në lidhje me përdorimin e simboleve (shenjat e komunikacionit, elementet e vizatimit teknik etj.), të shkurtimeve dhe të emërtimeve teknike.					
16.9.13	Udhëzuesi për mësuesin/en përfshin orientime për organizimin e punëve të dorës në punishten e shkollës ose në klasë, të ushtrimeve në laboratorin shkollor si dhe orientime për organizimin e vizitave në fabrika, në ndërmarrje prodhuese, në stacione të automjeteve, në aeroporte, në stacione të zjarrfikësve etj.					
16.9.14	Teksti shkollor përmban teste për vetëvlerësim që janë tërheqëse, gjithëpërfshirëse, të kuptueshme dhe të përdorshme nga nxënësi/ja.					

Vlera e standardit 16.9 = $\{[16.9.1 + - + 16.9.14] : 14\} = \underline{\hspace{2cm}}$

16.10 Teknologjia/TIK-u

Qëllimet: *Tekstet shkollore të luajnë rolin e mjetit ndihmës dhe të kontribuojnë në zhvillimin e njohurive dhe të kompetencave (veçanërisht, atë digjitale), në aspekte të ndryshme të profesionit. Ato të ndihmojnë nxënësit/et të çmojnë vlerat dhe potencialet e tyre, për t'u orientuar drejt karrierës profesionale dhe për të marrë përgjegjësi në zhvillimin e vazhdueshëm personal dhe profesional; të mbështetin nxënësit/et për të bashkëpunuar dhe për besim të ndërsjellë, nëpërmjet punës praktike; të jenë burim i njohurive për zhvillimin perspektiv të profesionit, në kontekstet e integritimit rajonal dhe europian. Teksti shkollor të përmbajë njohuritë dhe proceset më të reja teknologjike në sektorin e profesionit përkatës. Teksti shkollor të përmbajë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Këtyre qëllimeve t'u shërbejnë udhëzimet në lidhje me strategjitë e të nxënësve, përgatitja, hartimi dhe paraqitja e lëndës, të cilat mbështetin të nxënësve në mënyrë vepruese, aktive dhe motivuese.*

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.10.1	Teksti shkollor u përshtatet nivelit shkollor dhe qasjeve që përcakton kurrikula për këtë nivel (krahasoni standardin e përgjithshëm 1.1-1.3).					
16.10.2	Teksti shkollor ofron situata të nxënësve (materiale, sugjerime, prova, ushtrime, detyra, eksperimente) për secilin nivel të njohjes që ndihmojnë ndërtimin dhe zbatimin e njohurive të reja dhe të kompetencave.					
16.10.3	Format, mënyrat dhe ecuritë e paraqitjes së ligjshmërive në tekstin shkollor janë të thjeshta, të sakta dhe koherente.					
16.10.4	Teksti shkollor u referohet risive tekniko-teknologjike dhe nevojave që ka tregu i punës për përdorimin e TIK-ut në çdo fushë.					
16.01.5	Kuptimi i ligjshmërive në tekstin shkollor bazohet në arritjet e reja shkencore tekniko-teknologjike dhe në hulumtimet në laboratorë, në industri dhe në institucione kërkimore shkencore që i nxitin nxënësit/et të hulumtojnë dhe të nxënë të reja shkencore.					
16.10.6	Në tekstin shkollor, detyrat, provat, demonstrimet, eksperimentet, matjet e thjeshta, vëzhgimet u referohen zhvillimit të njohurive dhe të kompetencave, në pajtim me zhvillimin tekniko-teknologjik dhe mundësojnë integrimin e nxënësve/eve në tregun e punës.					

16.10.7	Teksti shkollor u ofron nxënësve/eve probleme, metoda zbatimi (matematikore, kimike, fizike etj.), zgjidhje interesante, tërheqëse, por dhe mundësi e sugjerime për të nxënëit në mënyrë hulumtuese dhe të pavarur.					
16.10.8	Teksti shkollor, përmes rezultateve eksperimentale, vëzhgimeve në terren /laborator/workshope dhe detyrave tipike, u ofron nxënës/eve mundësinë e të nxënëit në grup ose të pavarur, në përputhje me moshën e tyre.					
16.10.9	Detyrat, sugjerimet për punë të pavarur, ushtrimet, provat, demonstrimet dhe eksperimentet në tekstin shkollor janë hartuar për të nxitur motivimin, komunikimin dhe ndërveprimin e nxënësve/eve.					
16.10.10	Teksti shkollor është i përshtatshëm për punë të diferencuar me nxënësit/te dhe për punë të pavarur, sepse ofron, detyra, ushtrime, prova, demonstrime, eksperimente dhe vëzhgime të niveleve të ndryshme, sipas vështirësisë dhe kërkesave.					
16.10.11	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e edukimit shëndetësor dhe të ruajtjes së mjedisit.					
16.10.12	Në fund të tekstit shkollor, gjendet fjalori përmbledhës i termave kryesorë të trajtuar, si dhe treguesi i termave profesionalë.					
16.10.13	Në tekstin shkollor paraqiten rregullat e sigurimit teknik (varësisht profilit profesional).					
16.11.14	Në tekstin shkollor, korniza e përmbajtjes, e simboleve dhe e formulave, si dhe emërtimi i tyre është në përputhje me sistemin ndërkombëtar ISO (të njëjtit në "Sistemi SI"; IEC 60027; me standardet ndërkombëtare dhe me standardet e reja (aktuale) të profesionit, me rregullat e IUPAC-ut etj.					
16.10.15	Në tekstin shkollor, paraqiten kërkesat për cilësinë e prodhimeve, sipas standardeve aktuale.					
16.10.16	Teksti shkollor u ofron nxënësve/eve teknika dhe mënyra për vlerësim ose vetëvlerësim.					

Vlera e standardit 16.10 = {[16.10.1 + - + 16.10.16] : 16} = ____

16.11 Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti

Qëllimet: Teksti shkollor të vlejë posaçërisht për përvetësimin dhe për zhvillimin e njohurive, të shkathtësive dhe të shprehive motorike si dhe për zhvillimin e aftësive psiko-fizike të nxënësit/es. Teksti shkollor të ndihmojë mësuesit/et të organizojnë procesin mësimor sipas kërkesave bashkëkohore (shkencore dhe profesionale). Teksti shkollor të ndihmojë që nxënësit/et: a) të zhvillohen fizikisht sa më mirë të jetë e mundur (zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale); b) të ndërtojnë njohuritë e nevojshme, të përvetësojnë dhe të përforcojnë shkathtësi të ndryshme motorike; c) të përjetojnë këndshëm edukimin fizik dhe sportiv dhe të formojnë qëndrim të drejtë ndaj tyre.

Nr.	Treguesit	Vlerat				
		0	1	2	3	4
16.11.1	Struktura e përmbajtjes, simbolet, ilustrimi dhe emërtimi janë sipas qasjeve që përcakton kurrikula për këtë nivel (krahasoni standardin e përgjithshëm 1.1-1.3).					
16.11.2	Forma, ecuria dhe mënyra e paraqitjes së detyrave motorike në tekstin shkollor është në përputhje me karakteristikat antropologjike të nxënësit/es.					
16.11.3	Teksti shkollor është përgatitur dhe është hartuar për nxënie kolektive dhe nxënie individuale.					
16.11.4	Njësitë mësimore (nga tematikat) në tekstin shkollor janë përgatitur mirë (të ilustruara, me teknikat e ekzekutimit, me metodat e përvetësimit, me mënyrat e demonstrimit), që nxënësi/ja të përvetësojë si duhet detyrat motorike - lëvizore, gjatë ose jashtë procesit mësimor.					
16.11.5	Teksti shkollor i mundëson nxënësit/es ndërtimin dhe demonstrimin e koncepteve (terminologjive) që shfrytëzohen në lëndën e edukatës fizike dhe sportive, sipas rregullave dhe kërkesës së gjuhës shqipe.					
16.11.6	Në tekstin shkollor, ushtrimet dhe përmbajtjet e tjera të paraqitura ndikojnë në zhvillimin e aftësive motorike të nxënësit/es (forcë, shpejtësi, qëndrueshmëri, shkathtësi, lëvizshmëri etj.).					
16.11.7	Në tekstin shkollor, për ushtrimet e paraqitura përdoret terminologjia dhe ilustrimet e duhura.					
16.11.8	Në tekstin shkollor, janë përfshirë devijimet trupore (kifoza, lordoza, skolioza, shputat e këmbëve të rrafshëta, këmbët X dhe O) dhe përmbahen ushtrimet trupore që lejojnë nxënësin/en me devijimin përkatës të ushtrohen në mënyrë të pavarur, duke					

	ndikuar në përmirësimin e mbajtjes së trupit drejt.					
16.11.9	Teksti shkollor i mundëson nxënësit/es fitimin e njohurive mbi formimin dhe zhvillimin e jetës sportive, përjetimin e kënaqësisë gjatë garave dhe gjatë jetës, shoqërimin në shkollë dhe në mjedisin shoqëror.					
16.11.10	Përmes tekstit shkollor, nxënësi/ja aftësohet edhe për organizimin e ushtrimeve me nxënës/e të tjerë, ose me persona të interesuar nga mjedisi shoqëror.					

Vlera e standardit 16.11 = {[16.11.1 + - + 16.11.10] : 10} = _____

SHTOJCA 1: FORMULARI PËRMBLEDHËS

Emri i recensuesit _____

Titulli:	Autori/ët:
Lënda:	Botuesi/t:
Klasa:	Data e recensimit:

Standardi	Treguesi	Vlerat				
		0	1	2	3	4
Standarde të përgjithshme						
Pajtimi me kurrikulën, formatimi, paraqitja (standardet 1 - 3)						
1	Pajtimi me parimet gjithëpërfshirëse kurrikulare dhe me tekstet shkollorë të klasave pararendëse dhe pasuese (të së njëjtës lëndë)					
2	Faqosja, planifikimi/projektimi, qëndrueshmëria					
3	Ilustrimet					
Çështje shkencore dhe didaktike (standardet 4-8)						
4	Cilësia në lidhje me përmbajtjen e lëndës, rëndësinë dhe aktualitetin					
5	Përshtatja me moshën e nxënësve/eve					
6	Konceptimi dhe shtjellimet didaktike					
7	Pyetjet dhe udhëzimet për detyrat					
8	Aspektet gjuhësore					
Çështje pedagogjike (standardet 9-12)						
9	Lidhjet me realitetet shoqërore, historike dhe politike					
10	Çështjet edukative, pavarësia dhe pjekuria, edukimi për demokraci dhe për paqe					
11	Pasqyrimi i barazisë gjinore në tekstin shkollor					
12	Lidhja me çështje të tjera pedagogjike të rëndësishme					
Çështje që lidhen me praktikën pedagogjike (standardet 13-15)						
13	Teksti/udhëzuesi i mësuesit /es dhe përdorimi i tij					
14	Materialet që shoqërojnë tekstin shkollor					
15	Pilotimi i tekstit shkollor					
Standarde plotësuese sipas lëndës						
16						

Komente përmbledhëse, përfundimtare (në fletë shtesë)

- Vlerësimi i përgjithshëm i tekstit shkollor; vlerat dhe mangësitë e tij.
- Pikënisjet kryesore për përmirësimin/përpunimin.

BIBLIOGRAFIA

1. MAS, Komisioni për Miratimin e Teksteve, (2013), *Paketa "Altertekst 2013"*.
2. MASht, (2011), *Standarde për tekstet shkollore*. Lidhja: http://www.masht.gov.net/advCms/documents/standardet_e_teksteve.pdf
3. Ministry of Foreign Affairs of Japan (2014), *How a textbook becomes part of a school curriculum*. Lidhja: <http://www.mofa.go.jp/policy/education/textbooks/overview-1.html>
4. Ministère de l'Éducation, du Loisir et du Sport – Quebec (2014), *Instructional materials approved for secondary level*. Lidhja: http://www1.mels.gouv.qc.ca/bamd/doc/Liste_secondaire_ang_ref.pdf
5. Association of American Publishers (2014), *Quality Assurance Process for Instructional Materials*. Lidhja: <http://publishers.org/schoolquality/>
6. Huttova, J. & Nogova, M. (2005). *Education and Textbook Systems in the Slovak Republic*. Te: Hornsley, M., Knudsen, V. S., & Selander, S. (Eds.) (2005), *"Has Past Passed?" - Textbooks and Educational Media for the 21st Century*". The 7nd IARTEM Volume. Lidhja: <http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:179762/FULLTEXT01.pdf>
7. Pingel, F., (2010). *UNESCO Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision – 2nd revised and update edition*.
8. Becker, Gerold, et al (ed.; 2005), *Standards. Unterrichten zwischen Kompetenzen, zentralen Prüfungen und Vergleichsarbeiten*. (Issue 23 of Friedrich Jahresheft)
9. Council of Europe/Europarat (pa datë). *Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment*. Lidhja: http://www.coe.int/t/dg4/linguistic/source/framework_en.pdf
10. Exarhos, I. (2006), *Greek primary teachers' preferences for and characteristics of science textbooks*. Lidhja: <http://www.diva-portal.org/smash/get/diva2:179762/FULLTEXT01.pdf#page=218>
11. Georgescu, Dakmara; Jean Bernard (2007), *Thinking and Building Peace through Innovative Textbook Design*. Paris: UNESCO. Lidhja: <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001612/161254e.pdf>
12. Ministarstvo Prosvjete i Sporta [Republika e Kroacisë] (2003), *Udzbenicki standard*. Zagreb (Dokument për përdorim të brendshëm).
13. Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë (2006), *Koncepcioni për tekst shkollor të arsimit fillor dhe të mesëm*. Manastir. SHA "Kiro Dandaro".
14. Nogova, Maria; Jana Huttova (2006), *Process of Development and Testing on Textbook Evaluation Criteria in Slovakia*. Lidhja: http://www2.ef.jcu.cz/~cincurov/PhD/Zkou%C5%A1ky/Hospesova-XTVM/nogova_huttova.pdf
15. Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (2006), *Urdhër për krijimin e bordit të miratimit të teksteve shkollore* (Nr. 108, 28.3.2006).

LIDHJE TË TJERA

- <http://www.gei.de/en/the-institute.html>
- <http://www.ibe.unesco.org/en.html>
- http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/index_en.htm
- http://en.wikibooks.org/wiki/Wikibooks:Textbook_Standards